





ANËTARËT E AAB-së



PËRMBAJTJA

Bankieri

Nr. 40, Korrik 2021

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



REDAKSIA:

Elvin Meka
KryeredaktorEftali Peçi
KoordinatorëDorina Zarka
Fotografe**Design & Layout:** FCB Afirma**Shtypi nga:**  Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
www.aab.al

Editorial

Kapitalizimi i bankave – një sfidë komplekse
Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

5

Tema e Ditës

Korniza e mjaftueshmërisë së kapitalit - Sfida madhore e bankave në Shqipëri
Elona BOLLANO
Orjola BAKU

6

Tregjet e kapitalit si burim alternativ për përmbushjen e kërkesave rregullative për kapital të bankave

Flora MUSTA
Patris POSHNJARI

10

Instrumentet financiare dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik post-Covid-19
Fatmira KOLA, PhD

14

Intervista

"...Industria bankare duhet të dëgohet me të njëjtën forcë, si industria që ajo përfaqëson"
Bledar SHELLA, Kryetar i AAB-së

16

Sistemi Bankar

Credins Bank hap dyert e saj në Kosovë
Selman LAMAJ

18

Forumi i Ekspertëve

Kriza e Covid-19: Mbikëqyrja bankare përballë pasigurisë ekstreme
Gonzalo GASOS
Lukas BORNEMANN

21

Superekipet: "Inteligjenca Artificiale në grupe"
Rodan PAJAJ

25

Digjitalizimi dhe Posta Hibride: Transformimi i shërbimit postar dhe financiar shqiptar, jo-bankë

Gjergji HAMITI

27

Tregu i kriptomonedhave dhe politika monetare
Prof. Dr. Agim KUKELI
Dr. Nertil MERA

30

Motori i përfshirjes financiare ka nevojë për lubrifikantin e edukimit financiar, për të çuar përpara ekonominë

GERMAN SPARKASSENSTIFTUNG
FOR INTERNATIONAL COOPERATION

33

Pergjegjesia Sociale e Korporatës

35

AAB: Aktivitete - Trajnime

42

Edukimi Financiar

43

BORDI EDITORIAL:

Bledar SHELLA

Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të AAB,
Drejtor i Përgjithshëm,
Banka OTP Albania

Maltin KORKUTI

Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të AAB,
Drejtor i Përgjithshëm,
Credins Bank

Ervin METE

Drejtor i Përgjithshëm
Ekzekutiv,
Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare

Seyhan PENCABLIGIL

Zëvendës Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të AAB,
Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit Drejtues i Bankës Kombëtare Tregtare (BKT)

Dritan MUSTAFA

Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të AAB,
Drejtor i Përgjithshëm,
Tirana Bank

Adrian CIVICI

Dekan Fakulteti i Ekonomisë,
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të AAB,
Drejtor i Përgjithshëm,
Fibank Albania

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm,
Shoqata Shqiptare e Bankave

 *otpbank*

**Ti ke lindur
për gjëra të
mëdha**



Kapitalizimi i bankave – një sfidë komplekse

Kjo është një sfidë për të ngritur bankungun shqiptar në një nivel të ri veprimtarie, por dhe për të futur përfundimisht tregun dhe sistemin financiar shqiptar në rrugën e thellimit të tij të mëtejshëm.



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹

Kryeredaktor

Pas shpërthimit të krizës globale ekonomike dhe financiare të 2008, do të ishte industria bankare, më shumë sesa çdo lloj tjetër industrie apo sektori të ekonomisë, që do të përjetonte dhe do të përballlej me furinë e valës goditëse të vet krizës, por dhe me të gjithë arsenalin e masave të ndërmarra nga autoritetet rregullatore, kudo në botë.

E ndërsa pasojat e krizës u fashitën dhe u absorbuan, në sajë të ndërhyrjeve energjike dhe urgjente qeveritare dhe të autoriteteve rregullatore, përtej masave të vet bankave, do të ishin po i njëjti grup interesi (qeveria dhe autoritetet rregullatore), që do të vijonin me angazhimin e tyre në drejtim të shqyrtimit dhe aprovimit të masave dhe standardeve të reja më të rrepta, me qëllim minimizimin, apo frenimin e mundësisë që ngjarje të tilla me ndikime të thella në ekonomi dhe sistemin financiar të fashiteshin,

në rast dështimi të bankave. Konkretisht, këto paketa rregullash dhe standardesh, të materializuara në kornizat Bazel III në 2009 dhe Bazel IV në 2017, kishin për qëllim themelortë bënin bankungun një veprimtari jo vetëm më të sigurt, por dhe më pak gjenerues krizash në të ardhmen, të cilat falë dhe ndërlikohjes ekstreme që kanë ekonomitë dhe sistemet financiare në rrafsh global, mund ta hedhin botën, ekonominë dhe sistemin e saj financiar në humnera me thellësi ende të panjohura për të gjithë ne.

Këto masa e standarde kanë përmirësuar dukshëm jo vetëm shëndetin e bankungut në përgjithësi, por dhe reputacionin e imazhin e tij. Nga ana tjetër, ndërkohë që këto masa e standarde e treguan efikasitetin e tyre gjatë pandemisë COVID-19, ku i gjithë sistemi bankar global, e patjetër dhe ai shqiptar, përballuan me sukses goditjet e befasishme të krizës shëndetësore dhe ato ekonomiko-sociale, ato u shoqëruan e po vijojnë të shoqërohen me një kosto të shtuar për ushtrimin e veprimtarisë bankare, kryesisht në aspektin e kërkesave të shtuara për mjaftueshmërinë e kapitalit, veçanërisht për bankat sistemike, kjo dhe në kuadër të pajtueshmërisë me rregullat për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, që aktualisht janë dhe pjesë e bazës rregullatore të veprimtarisë bankare në Shqipëri.

Në kontekstin e sektorit bankar shqiptar, deri më sot kërkesat e shtuara për kapital janë plotësuar kryesisht përmes rrugës tradicionale

të injektimit të kapitalit aksionar dhe më pak përmes emetimit të borxhit të varur (edhe në formën e obligacioneve me ofertë private). Ndërkohë që, ulja e ekspozimeve, si një alternativë për sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit është jashtë diskutimit, e në kushtet kur injektimi i kapitalit të ri aksionar po bëhet gjithnjë e më i shtrenjtë, bankat sistemike përgjatë viteve në vijim, deri në vitin 2027, do të duhet të përballen dhe menaxhojnë emetimin e një shume relativisht të konsiderueshme, në formën e obligacioneve me ofertë publike. Ky kapitalizim përbën një sfidë komplekse për to, jo vetëm në aspektin e ballafaqimit të tyre me tregun shqiptar të kapitaleve, por dhe me identifikimin e tërheqjen e investuesve institucionalë, për të blerë këtë paketë letrash me vlerë. Aktualisht, sistemi financiar shqiptar ofron infrastrukturën bazë të tregtimit dhe regjistrimit të këtyre titujve (ALSE dhe ALREG janë tashmë institucione funksionale në treg), e po ashtu, disa investues potencialë institucionalë vendas janë të pranishëm në treg. Në finale, kjo është një sfidë jo vetëm për bankat dhe veprimtarinë e tyre, por dhe për vet autoritetet rregullatore (Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare), si dhe të gjithë pjesëmarrësit në tregun financiar shqiptar. Kjo është një sfidë për të ngritur bankungun shqiptar në një nivel të ri veprimtarie, por dhe për të futur përfundimisht tregun dhe sistemin financiar shqiptar në rrugën e thellimit të tij të mëtejshëm!

¹ Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës, UET.

Korniza e mjaftueshmërisë së kapitalit

Sfida madhore e bankave në Shqipëri

Periodha e ndërmjetme që është vënë në dispozicion për të zbatuar disa nga kërkesat rregullatore mund të jetë momenti më i përshtatshëm për autoritetet rregullatore në vend që të rishikojnë nga një këndvështrim i gjerë efektin e mundshëm të masave të ndërmarra, me qëllim shmangien e incentivave të padëshiruara, që mund të dëmtojnë sektorin bankar dhe ekonominë



Elona BOLLANO

Drejtuës, Departamenti i Risqeve të Tregut
BANKA KOMBËTARE TREGTARE



Korniza e zgjeruar e kërkesave për kapital në Shqipëri bazohet përgjithësisht në standardet ndërkombëtare. Kjo bën që vlerësimi i rreziqeve dhe kërkesat cilësore për mbulim me kapital për bankat në vend të jenë të ngjashme me bankat që operojnë jashtë Shqipërisë.



Orjola BAKU

Drejtoreshë e Departamentit të Menaxhimit të Riskut,
Divizioni i Menaxhimit të Riskut,
INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA



Korniza e mjaftueshmërisë së kapitalit përbëhet nga një grupim i gjerë standardesh rregullative, të cilat kanë për qëllim të përcaktojnë rregullat që duhet të ndjekin bankat, lidhur me kërkesat për kapital, si dhe mënyrën e mbikëqyrjes nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse. Këto standarde rregullative kanë për qëllim të përmirësojnë aftësinë e sektorit bankar për të absorbuar goditjet nga faktorët financiarë dhe ekonomikë, të përmirësojnë qeverisjen dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe të sigurojnë transparencë dhe informacion për publikun.

Në kushtet e zhvillimit të vazhdueshëm të sektorit bankar, globalizmit dhe pranisë së bankave që e kanë të shtrirë veprimtarinë e tyre në shumë shtete, ekzistenca

dhe zbatimi i standardeve të harmonizuara dhe të unifikuara është një kërkesë e domosdoshme. Standardet e unifikuara sigurojnë transparencë dhe trajtim të njëjtë midis institucioneve, si dhe shërbejnë si bazë për të ndërtuar një përjasje të ngjashme ndaj rreziqeve, çka mund të çojë edhe në një ulje të përgjithshme të shkallës së rrezikut.

Në Shqipëri, korniza e mjaftueshmërisë së kapitalit është ndërtuar me referencë Kornizën e Bazelit dhe paketën rregullatore të Direktivës 2013/36/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (CRD IV). Korniza e Bazelit është hartuar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare. Kjo kornizë shërben si standard për bankat qendrore, apo autoritetet mbikëqyrëse, gjatë procesit të

ndërtimit të kornizës së brendshme rregullatore. Autoritetet mbikëqyrëse të çdo vendi kanë mundësinë që këtë standard ta modifikojnë, apo përshtatin me kuadrin e tyre rregullator, pa prekur thelbin e standardeve. Qëllimi kryesor i kornizës është forcimi i qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndërkombëtar, duke inkurajuar bankat që të përmirësojnë praktikën e tyre të qeverisjes dhe të menaxhimit të rrezikut.

Korniza e Bazelit daton në korrik 1988 me Basel Capital Accord, apo siç njihet ndryshe Basel I, i cili në pasqyrim të zhvillimeve financiare dhe ekonomike, është modifikuar në vite në Basel II, Basel III dhe Basel IV. Në çdo rishikim të kornizës së kapitalit është bërë një ndarje dhe identifikim më i

qartë i rreziqeve, të cilat duhet të mbulohen me kapital, duke shtuar edhe kërkesat për rrezikun e normës së interesit dhe likuiditetit.

Në Shqipëri, korniza e Bazelit ka filluar të integrohet në kuadrin rregullator nga Banka e Shqipërisë në vitin 1999, me kuadrin rregullator mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe kapitalit rregullator. Si referencë për të hartuar kuadrin rregullator është përdorur Basel I në një formë të thjeshtuar dhe të modifikuar, për t'ju përshtatur nivelit të zhvillimit të sektorit bankar në vend. Norma minimale e mjaftueshmërisë së kapitalit e vendosur nga kjo kornizë rregulloresh ishte 12.0%, nga 8.0% që është përcaktuar si nivel fundor nga ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe si referencë nga korniza e Bazelit dhe Direktiva Evropiane. Kjo normë më e lartë për kapital në vendin tonë mund të ketë marrë në konsideratë një përjashtësi më të kujdesshme dhe nivel më të lartë të kundërshtimit të rrezikut nga autoriteti mbikëqyrës (Banka e Shqipërisë).

Në vitin 2013, Banka e Shqipërisë publikoi versionin e parë të rikonceptuar të mjaftueshmërisë së kapitalit, në linjë me Shtyllën I të Basel II. Korniza e rikonceptuar e mjaftueshmërisë së kapitalit prezantoi disa risi, lidhur me kërkesat për kapital të bankave, duke bërë një lidhje më të mirë midis nivelit të rrezikut dhe kërkesës për mbulim me kapital. Pavarësisht zbatimit të një metodologjie më të sofistikuar dhe shtimit të burimeve të rrezikut, për të cilat kërkohej kapital, edhe në këtë rishikimin të rregullores norma minimale e mjaftueshmërisë së kapitalit mbeti 12.0%.

Në vazhdimësi, në vitin 2017, Banka e Shqipërisë shtoi kërkesën për zbatimin e procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (PVBMK), bazuar në Shtyllën II të Kornizës së Bazelit. Shtylla II, ose procesi i rishikimit mbikëqyrës synon të sigurojë që banka ka nivel të mjaftueshëm kapitali për të mbuluar rreziqe të ndryshme që lindin gjatë veprimtarisë, si dhe të nxisë zhvillimin e një praktike më të mirë të administrimit të rreziqeve. Ky proces i kërkon drejtuesve të bankës të përcaktojnë normën e synuar të kapitalit, e cila duhet të pasqyrojë profilin e rrezikut të bankës. Drejtuesit e bankës kanë gjithashtu përgjegjësinë që të ruajnë nivelin e duhur të kapitalit mbi nivelin minimum, me qëllim mbulimin e rreziqeve. Gjatë kryerjes së PVBMK-së analizohen faktorët kryesorë të rrezikut, edhe ato rreziqe që nuk përfshihen në Shtyllën I, si: rreziku i normave të interesit dhe rreziku i likuiditetit. Nëpërmjet këtij procesi, rregullatorët synojnë që, nëse evidentohen mangësi, të mund të ndërmerren masa të menjëhershme, për të frenuar në një fazë të hershme rrezikun ose për të rritur kapitalin¹.

Kriza financiare e periudhës 2007 – 2008 tregoi se udhëzimet në nivel mikroprudencial mund të mos ishin të mjaftueshme për të menaxhuar rreziqet sistemike. Në këto kushte, Komiteti i Bazelit përcaktoi kërkesën shtesë për mbajtjen e shtesës konservuese të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike, për të ulur mundësinë e dështimit. Shtesa konservuese e kapitalit do të jetë 2.5% e kapitalit bazë të nivelit të parë, e shprehur si përqindje në raport

ndaj ekspozimeve të peshuara me rrezik të bankës. Gjithashtu, Komiteti ka udhëzuar për mbajtjen e një shtese kundërciklike të kapitalit, në nivelin 2.5% për të adresuar rreziqet që mund të lindin nga rritja e shpejtë e kreditimit në një vend.

Në vitin 2019, autoriteti i stabilitetit financiar në Bankën e Shqipërisë miratoi shtesat makroprudenciale të kapitalit: shtesa konservuese e kapitalit në 2.5%; shtesa kundërciklike e kapitalit në 2.5%; shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST), që zbatohet ndaj bankave me rëndësi sistemike (BARS), në 3%; dhe shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik (STRUK) në 3%². Shtesa makroprudenciale e kapitalit përmbushet me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe shprehet në përqindje ndaj ekspozimeve të peshuara me rrezik. Tërësia e shtesave makroprudenciale përfaqëson shtesën e kombinuar makroprudenciale të kapitalit. Nëse shtesa makroprudenciale zbatohet e plotë³, siç është përcaktuar nga kuadri rregullator, mund të arrijë deri në 9.5% të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike.

Në kuadër të parandalimit të bankave për të falimentuar, më 2016 u miratua ligji "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë". Sipas ligjit, një strukturë e re u krijua pranë Bankës së Shqipërisë: "Ndërhyrja e jashtëzakonshme", e cila, ndër të tjera, ka për detyrë të përcaktojë për secilën bankë në Shqipëri, kërkesën për kapital dhe detyrime të pranuar. Në dhjetor 2020, po ky autoritet miratoi

¹ Basel II: International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards: A Revised Framework - Comprehensive Version.

² Për bankat BARS, SIST dhe STRUK-ut, të mbledhur me njëri-tjetrin, nuk duhet të kapërcejë vlerën 4%.

³ Shtesat makroprudenciale kanë filluar të zbatohen gradualisht nga viti 2020 dhe efekti i plotë i shtesave fillon nga viti 2024.

rregulloren: “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”, e cila hyn në fuqi në tetor 2021. Një nga kërkesat e përgjithshme të kësaj rregullore është që çdo bankë të zotërojë instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar, në nivelin që mundëson përthithjen e humbjeve dhe rivendosjen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, në masën që siguron vazhdimësinë e kryerjes së veprimtarive për të cilat banka është licencuar sipas ligjit për bankat, në rast se zbatohet ndërhyrja e jashtëzakonshme.

Në këtë këndvështrim, një nga objektivat kryesore të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është që të promovojë “ri-kapitalizimin nga brenda”. Kërkesa për MREL luan një rol thelbësor në arritjen e këtij objektivi, pasi plotësimi i MREL-it garanton që bankat të kenë detyrime të pranuar, në nivele të tilla që të mundësojnë përdorimin sa më efektiv të ri-kapitalizimit nga brenda. Prandaj këto detyrime duhet të jenë sa më afatgjata, mundësisht të jenë borxhe të varura, që të përshpejtojnë procesin e ri-kapitalizimit nga brenda. Në mungesë të këtyre detyrimeve të pranuar, kërkesat për MREL realizohen nëpërmjet rritjes së kapitalit të detyruar (sipas rregullores plotësohen njëherë kërkesat për kapital të MREL dhe më pas shtesat makroprudenciale). Realizimi i kërkesës për kapital shtrihet proporcionalisht në një periudhë të caktuar kohore.

Në një situatë të tillë, bankat, për të plotësuar kërkesat e MREL, do të detyrohen të zgjedhin disa

strategji, si për shembull: a) të rrisin detyrimet e pranuar, që do të rrisin likuiditetin e bankave. Por, nga ana tjetër, bankat në përgjithësi në Shqipëri, e në veçanti ato sistemike, karakterizohen nga një nivel i lartë likuiditeti, duke u detyruar të investojnë edhe me norma negative në mungesë të një tregu dytësor të instrumenteve financiare; b) të rrisin kapital – investuesit duhet të injektojnë më shumë kapital; c) të ulin mjetet financiare që absorbojnë më shumë kapital – për shembull, të ulin portofolin e huave të pasiguruara, ku efekti më i madh është te individët. Të gjitha këto kërkesa minimale për kapital synojnë të rrisin qëndrueshmërinë e sektorit bankar. Për të administruar shkallën e përdorimit të borxhit në financimin e aktiveve të bankës, në vitin 2020 u shtua edhe një kërkesë tjetër rregullatore: “Mbi raportin e levës financiare në banka”. Leva llogaritet si raport i kapitalit të nivelit të parë të bankës me ekspozim total të bankës. Për këtë tregues, edhe pse metodologjia e llogaritjes është bazuar në standardet ndërkombëtare, të rregullorja (EU) 2019/876 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Basel III, norma minimale e përcaktuar për Shqipërinë është 5.75%, proporcionalisht më e lartë se norma minimale prej 3% e përcaktuar nga standardet e referuara më lart.

Shuma e të gjitha kërkesave për kapital të paraqitura më lart – kërkesa minimale për kapital (12%), kërkesa për kapital për Shtyllën II dhe kërkesat shtesë makroprudenciale, - rezulton se mund të variojë nga 20.5 në 24.5%, në varësi të rëndësisë

sistemike dhe të strukturës së bilancit të bankës⁴. Në dhjetor 2020, mesatarja e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar ishte 18.3%. Për të arritur një normë mesatare të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 22.5%, sipas kërkesave rregullative, bankat do të duhet të aktivizojnë rreth 37.5 miliardë lekë (ose rreth 305 milionë euro) kapital⁵, ose të ulin me 166.6 miliardë lekë (ose rreth 1.4 miliardë euro) aktivet.

Nga një këndvështrim i parë mund të duket se kërkesat më të larta për kapital do të sigurojnë që bankat të jenë më të sigurta, pasi rreziqet janë mbuluar më mirë me kapital. Nga ana tjetër, kapitali është një burim i kushtueshëm financimi dhe rritja e kërkesës për këtë burim financimi do të rriste ndjeshëm kostot e bankës. Kosto e rritura do të transferohen ose do të mbulojnë duke ndërmarrë veprimtari me rrezik të lartë. Ky efekt zinxhir veprimesh do të çonte në rritjen e mundësisë së falimentimit të bankës, çka është në kundërshtim me qëllimin fillestar të rritjes së kërkesës për kapital.

Për të vlerësuar më mirë ndikimin e nivelit të kapitalit në banka në shkallën e rrezikut mund të vëzhgohet literatura dhe evidencat empirike në këtë fushë. Ka disa studime të kryera, që konfirmojmë qëndrimin se kërkesat për kapital nxisin sjellje prudençe, pasi ulin nxitësit për të vënë në rrezik kapitalin, por, gjithsesi, këto kërkesa kanë edhe një efekt anësor negativ, pasi dëmtojnë vlerën e franshizës⁶ së bankës, duke i shtyrë këto të fundit të ndërmarrin veprime

⁴ Për këtë llogaritje është supozuar një normë prej 3% për të mbuluar të gjitha kërkesat për kapital për Shtyllën II.

⁵ Këtu nuk konsiderohet efekti dytësor i rritjes së kapitalit në aktive.

⁶ Vlera e franshizës është vlera aktuale e fitimeve të ardhshme që një firmë pritet të fitojë, duke supozuar vazhdimësinë e pandërprerë në të ardhmen e firmës, going concern.

me rrezik (Hellmann, Murdock, Stiglitz 2000). Nga ana empirike është provuar, duke kontrolluar sjelljen e bankave në disa vende, se kërkesat e shtuara për kapital mund të nxisin "oreksin" për të marrë përsipër rrezik (Lundtofte & Nielsen 2014 dhe Rahman, Ahmad, Abdullah 2012). Sipas Ghosh 2014, bankat, në përgjithësi, e rrisin kapitalin për të reaguar ndaj rrezikut dhe jo e kundërta. Një nga mekanizmat që vepron në praktikë, sipas Lundtofte & Nielsen 2014, i cili evidentohet në bankat amerikane për periudhën 2002 – 2014, është se kur kapitali i bankës nuk përcaktohet nga rregulloret, vendimet për investime merren bazuar në treguesit e rrezikut, si: luhatshmëria e flukseve të parasë, humbja e pritur nga rreziku i falimentimit, si dhe nga norma e kthimit e përshtatur për nivelin e rrezikut (Sharpe ratio).

Megjithatë, kur kapitali i bankës përcaktohet nga rregullatorët, kostoja rregullatore bëhet një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në vendimmarrje, duke shkuar deri aty sa edhe të zëvendësojë analizën e treguesve të rrezikut, luhatshmërinë dhe normën e përshtatur me rrezik të kthimit. Nëse rregullatori përcakton rregulla edhe më të forta, bankat mund të ulin ose të risin ekspozimin e tyre ndaj aktiveve me rrezik, në varësi të normës shpërblim-kosto rregullatore.

Diamond dhe Rajan 2020, i kanë konsideruar ndikimin e kërkesave për kapital edhe nga një këndvështrim tjetër. Sipas tyre, kapitali i bankës është i kushtueshëm jo vetëm duke elidhur me kostot tradicionale të emetimit të kapitalit të ri, por i lidhur edhe me koston e vazhdueshme të uljes së likuiditetit dhe shkallës së kreditimit në ekonomi. Struktura optimale e kapitalit në një bankë duhet të përcaktohet duke balancuar 3 efekte: rritja e kapitalit rrit koston që absorbohet nga banka, rrit mbrojtjen ndaj goditjeve dhe ndryshon sasinë e fondeve që mund të përdoret nga huamarrësit. Struktura optimale fillestare e kapitalit për një bankë varet nga shkalla e konkurrencës në sektorin bankar, natyra e huamarrësve dhe kapitali që mund të gjenerojnë aksionarët.

Në përgjithësi, siç u paraqit edhe më lart, mund të thuhet se korniza e zgjeruar e kërkesave për kapital në Shqipëri bazohet përgjithësisht në standardet ndërkombëtare. Kjo bën që vlerësimi i rreziqeve dhe kërkesat cilësore për mbulim me kapital për bankat në vend të jenë të ngjashme me bankat që operojnë jashtë Shqipërisë. Ndërkohë, mund të evidentohet se, nga ana sasiore, kërkesat rregullatore për kapital në Shqipëri janë ndjeshëm më të larta se përcaktimet në standardet ndërkombëtare. Për rikujtesë, norma minimum e kapitalit

është 12% nga 8% e standardeve ndërkombëtare dhe raporti i levës është 5.75% nga 3% e standardeve ndërkombëtare. Kërkesa e përgjithshme për kapital mund të arrijë deri në 24.5%, çka do t'i vinte bankat përballë dy zgjedhjeve: rritjes së kapitalit, apo uljes / zvogëlimit të veprimtarisë. Siç u paraqit edhe më lart, evidencat empirike nga vende të ndryshme dhe gjatë periudhave të ndryshme në kohë, tregojnë se kërkesat për kapital shërbejnë për të rritur sigurinë e bankave. Megjithatë, nëse këto kërkesa janë shumë të larta, mund të krijojnë incentiva të padëshiruara për bankat. Këtu mund të përmenden incentiva si: përfshirja në investime me rrezik të lartë, që do të çonte në rritjen e mundësisë së dështimit për bankën, ose frenim i krijimit të likuiditetit dhe frenimi i kreditimit, që do të sillte pasoja të drejtpërdrejta për ekonominë e vendit. Kjo periudhë e ndërmjetme që është vënë në dispozicion për të zbatuar disa nga kërkesat rregullatore mund të jetë momenti më i përshtatshëm për autoritetet rregullatore në vend që të rishikojnë nga një këndvështrim i gjerë efektin e mundshëm të masave të ndërmarra, me qëllim shmangien e incentivave të padëshiruara, që mund të dëmtojnë sektorin bankar dhe ekonominë.

Referenca:

Diamond DW, Rajan RG. A theory of bank capital. *The Journal of Finance*. 2000;55(6):2431-2465

Ghosh S. Risk capital and financial crisis—Evidence for GCC banks. *Borsa Istanbul Review*. 2014;14(3):145-157

Hellmann Th, Murdock K, Stiglitz J. Liberalization, Moral Hazard in Banking, and Prudential Regulation: Are Capital Requirements Enough?. *American Economic Review*, vol. 90, no. 1, March 2000.

Lundtofte F, Nielsen CY. The effect of stricter capital regulation on banks' risk-taking: Theory and evidence. 2018. DOI: 10.2139/ssrn.2674236.

Rahman N, Ahmad N, Abdullah N, Ownership Structure, Capital Regulation and Bank Risk Taking, *Journal of Business and Economics*, March 2012, Volume 3, No. 3, ISSN 2155-7950.

Tregjet e kapitalit si burim alternativ për përmbushjen e kërkesave rregullative për kapital të bankave

Aktivizimi i mundshëm i sektorit bankar përmes emetimit të obligacioneve me ofertë publike në tregjet e kapitalit përbën një moment të përshtatshëm, pasi tashmë në vend janë krijuar të gjitha parakushtet dhe infrastruktura e plotë për funksionimin e tregjeve të kapitalit.



FLORA MUSTA

Drejtoresh
Drejtorja e Mbikëqyrjes së Tregut të
Kapitaleve
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE



Shrytëzimi i potencialit të tregjeve të kapitalit nga ana e bankave, për efekt të plotësimit të kërkesave rregullatore, jep një shembull të mirë për t'u ndjekur nga bizneset shqiptare për t'i ndërgjegjësuar emetuesit privatë për përparësitë e një listimi të mundshëm në bursë dhe për orientimin e tyre drejt alternativave të tjera të financimit.



PATRIS POSHNJARI

Përgjegjëse
Sektori i Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Ndërveprimi i sektorit bankar me tregjet e kapitalit pasqyrohet dukshëm në angazhimin e bankave në rolin e ofruesit të shërbimeve të investimeve, përfshirë shërbimet e kujdestarisë për tituj, por edhe në praninë e tyre si investues institucionalë në tituj, apo si emetues të obligacioneve me ofertë private. Ky ndërveprim përforcon faktin që këto dy shtylla të rëndësishme të sistemit financiar shqiptar nuk duhen konsideruar si konkurrese të njëra-tjetrës, por si plotësuese, në funksion të një sistemi financiar të zhvilluar dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi.

Institucione të konsoliduara, si bankat, janë të domosdoshme për mirëfunksionimin e tregjeve të kapitalit dhe anasjelltas, tregje eficientë të kapitalit janë thelbësore për mirëkapitalizimin e bankave, me qëllim që këto të fundit të mundësojnë kreditimin e ekonomisë pa rrezik të shtuar në stabilitetin e sistemit bankar. Rrjedhimisht, që prej vitit 2011, me nisjen e emetimeve të para të obligacioneve me ofertë private, bankat u kthyen në aktorë kyç të vitalizimit të tregut të kapitaleve, përmes rolit të tyre si emetues të obligacioneve me ofertë private, duke e furnizuar tregun e kapitaleve me instrumente të rinj

financiarë. Në këtë mënyrë, tregu i obligacioneve me ofertë private, që ka pësuar rritje të konsiderueshme që prej fillimeve të tij, së bashku me tregun e titujve të Qeverisë Shqiptare, përbën segmentin më aktiv të tregjeve të kapitalit në Shqipëri. Aktualisht, portofoli i obligacioneve me ofertë private është 8.56 miliardë lekë. Në treg janë të pranishëm 7 emetues, 4 prej të cilëve janë banka. Në veçanti njëra prej bankave ka një historik të gjatë të emetimit të obligacioneve me ofertë private dhe ka përmbyllur me sukses 19 emetime të tilla. Për emetimin e obligacioneve me ofertë private,



ProCredit Bank



ZONA 24/7

tashmë dhe në qytetin e Fierit



(Sheshi Pavarësia, pranë Prefekturës Fier)

emetuesi përgatit akt-ofertën, e cila regjistrohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në mbështetje të kërkesave të Ligjit të ri nr. 62/2020 "Për tregjet e kapitalit".

Prirja në rritje e tregut të obligacioneve të emetuara me ofertë private tregon se ekziston potenciali në anën e ofertës për emetimin e titujve korporativë edhe me ofertë publike dhe tregtimin e tyre përmes bursës, duke furnizuar njëkohësisht tregun e kapitaleve me instrumente financiare.

Në prirjen për rritje potenciale të ofertës për tituj borxhi, përmes emetimit të obligacioneve të emetuara nëpërmjet një oferte private, apo publike, pritjet të ndikojë edhe kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL), përcaktuar në direktivën BRRD II. Në mbështetje të kësaj direktive, si dhe në zbatim të Ligjit nr.133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ka miratuar rregulloren: "Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar". Në përmbushje të kësaj kërkesë, tregjet e kapitalit mund t'u sigurojnë bankave burime të mjaftueshme, me qëllim sigurimin e kapaciteteve për përthithjen e humbjeve dhe për rikapitalizim, në funksion të zgjidhjes së problemit "Too Big to Fail", identifikuar në sistemin bankar kudo në botë, pas ngjarjeve të krizës financiare të vitit 2008.

Në zbatim të kërkesave rregullatore, nevojitet të ndërmerren parashikime nga ana e bankave dhe të bëhet kalibrimi i treguesit MREL, i cili përcaktohet rast pas rasti për bankat, në bazë

të karakteristikave specifike të tyre si madhësia, modeli i biznesit, modeli i financimit apo profili i rrezikut të tyre. Në kuadër të kërkesave për kapital rregullator, disa banka kanë kontribuar në krijimin e instrumenteve të rinj financiarë në tregun shqiptar të kapitalit, siç janë: obligacionet e varura (nënrenditura) dhe ato të konvertueshme, ku këto të fundit i japin të drejtën obligacion-mbajtësit të shndërrohet në aksionar të bankës, në përputhje me metodën e konvertimit të obligacioneve në aksione.

Aktivizimi i mundshëm i sektorit bankar përmes emetimit të obligacioneve me ofertë publike në tregjet e kapitalit përbën një moment të përshtatshëm, pasi tashmë në vend janë krijuar të gjitha parakushtet dhe infrastruktura e plotë për funksionimin e tregjeve të kapitalit. Kështu, në treg ekzistojnë të gjithë ndërmjetësit e nevojshëm financiarë. Krijimi i një tregu të rregulluar nëpërmjet licencimit të Bursës Shqiptare të Titujve - ALSE në vitin 2017 dhe bërjes operacionale në vitin 2018 ka krijuar premisat për realizimin e emetimeve me ofertë publike përmes bursës, si dhe për tregtimin e këtyre titujve në të.

Gjithashtu, përmes licencimit nga Banka e Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të "Regjistrimit Shqiptar të Titujve-ALREG", si një institucion që merr kompetencat e një Depozitari Qendror të Titujve për klerimin dhe shlyerjen e titujve korporativë, është krijuar infrastruktura e nevojshme për ecurinë e tregut të kapitaleve në vend. Me pranimin në muajin mars 2021 të ALREG si pjesëmarrës i tërthortë në sistemin AIPS të Bankës së Shqipërisë, infrastruktura e pastregtimit është bërë plotësisht funksionale. Krahas këtyre zhvillimeve, vlen të

përmendet përmirësimi i kuadrit ligjor, si rezultat i miratimit të dy ligjeve të reja në fushën e tregut të kapitaleve: Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit" dhe Ligji nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive". Këto ligje janë hartuar në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian dhe synojnë t'i përgjigjen më së miri zhvillimit të këtyre tregjeve, integritetit të tyre dhe mbrojtjes së investuesit, si dhe rritjes së besimit të tij në mekanizmat e tregut.

Aktualisht, AMF po punon edhe për plotësimin e kuadrit rregullator me asistencë të ekspertizës së Bankës Botërore. Listimi dhe pranimi për tregtim i titujve të emtuar me ofertë publike në bursë shoqërohet me publikimin e prospektit të plotë, i cili miratohet nga AMF, në përputhje me kërkesat e ligjit të ri për tregjet e kapitalit.

Mbështetur në nenin 44 të direktivës BRRD si edhe në nenin 11 të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar", bankat, në rast emetimi, duhet të dokumentojnë testin e përshtatshmërisë, sipas dispozitave të ligjit për tregjet e kapitalit. Mbi bazën e këtij testi, instrumenti kompleks (obligacioni i varur, obligacioni i konvertueshëm, etj.) duhet të jetë i përshtatshëm për klientin joprofesionist, si kusht për njohjen e instrumenteve që zotërohen nga klientë joprofesionistë, për qëllime të kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar. Në këtë drejtim AMF, në bazë të nenit 64 dhe 65 të ligjit: "Për Tregjet e Kapitalit", ka miratuar rregulloren nr. 197, datë 29.12.2020: "Për vlerësimin e përshtatshmërisë së

klientit”, e cila gjen zbatim edhe ndaj emetuesve të titujve të borxhit, apo kapitalit.

Mundësia e një emetimi të mundshëm nga bankat përmes një oferte publike mbështetet edhe nga fakti se sektori bankar është nga sektorët më të zhvilluar dhe mirërregulluar, rrjedhimisht i aftë për të përmbushur kriteret për listim, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të bursës. Besimi i investuesit të tregjet dhe institucionet financiare është i lidhur ngushtë me besimin e tij në cilësinë e raportimit financiar. Për këtë arsye, njësitë me interes publik, përfshirë shoqëritë e listuara dhe bankat, janë subjekt i detyrimit për raportim financiar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas kërkesave të ligjit për tregjet e kapitalit. Në këto kushte, bankat janë të afta për të përmbushur kërkesat për transparencë dhe raportim financiar.

Përveç kushteve tashmë të krijuara në tregjet e kapitalit

për nxitjen dhe mbështetjen e ofertës përmes emetimeve me ofertë publike, rëndësi ka edhe vlerësimi i kapaciteteve të tregut për të përthithur borxhin e varur që pritet të emetohet në zbatim të kërkesave për MREL. Në këtë drejtim, domosdoshmëri përbën diversifikimi dhe zgjerimi i bazës së investuesve përmes pranisë së investuesve institucionalë apo individë (vendos apo të huaj) për nxitjen e kërkesës në treg, me synim përputhjen e kërkesë-ofertës. Mbështetur në eksperiencat e mëparshme të nënshkrimit të këtyre titujve, të emetuar me ofertë private nga bankat, gjykohet se ka likuiditet të mjaftueshëm për të përthithur emetimet e reja.

Mbështetur në eksperiencën e vendeve të rajonit, përthithja nga tregu i instrumenteve të emetuara nga bankat është bërë edhe nga investues ndërkombëtarë, përmendim këtu rastin e Kroacisë, ku së fundmi Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) investoi rreth 9 milionë euro në

blerjen e obligacioneve të emetuara nga një bankë lokale e Kroacisë për efekt të kërkesave për MREL dhe të listuara në Bursën e Zagrebit.

Shfrytëzimi i potencialit të tregjeve të kapitalit nga ana e bankave, për efekt të plotësimit të kërkesave rregullatore, jep një shembull të mirë për t'u ndjekur nga bizneset shqiptare për t'i ndërgjegjësuar emetuesit privatë për përparësitë e një listimi të mundshëm në bursë dhe për orientimin e tyre drejt alternativave të tjera të financimit.

Për vet rëndësinë e tregjeve të kapitalit dhe potencialit të pashfrytëzuar të këtij tregu në ekonominë e vendit, AMF ka vendosur si prioritet rolin e saj proaktiv në zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri. Për këtë qëllim, AMF po bashkëpunon me aktorët e tregut në reformimin e tregjeve të kapitalit, si dhe me institucione me rol kyç në zhvillimin e këtij tregu.



Instrumentet financiare dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik post-Covid-19

Jetësimi dhe përdorimi i instrumenteve financiarë kërkon njohuri specifike në fushën e financës dhe aftësi menaxheriale; për këtë është esenciale prania e sektorit bankar si ndërmjetës, konsulent dhe partner strategjik.



Fatmira KOLA, PhD

Eksperte në Financë Ndërkombëtare dhe Menaxhim Rreziku

Pedagoge dhe Trajnuese, Albanian University SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE (ASPA)

Tërmeti dhe kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19 mund të konsiderohet si një mundësi e re për ekonominë, për të trajtuar problemet e mbartura nga e shkuara dhe për të riorientuar zhvillimin ekonomik drejt një modeli më të qëndrueshëm, nëpërmjet inkurajimit të reformave strukturore dhe duke nxitur investimet në inovacion e infrastrukturë, si një mjet thelbësor për të përballuar sfidat që na presin. Kriza ka nxjerrë në pah nevojën për investime strategjike, veçanërisht për digjitalizimin, infrastrukturën, bujqësinë, turizmin dhe pajisjet mjekësore. Një element tjetër i rëndësishëm për përballimin e krizës aktuale është dhe

vijueshmëria e reformave institucionale, politike dhe monetare ekspansioniste, duke mbështetur veçanërisht bizneset e vogla dhe të mesme dhe disa sektorë kyç në zhvillimin ekonomik dhe social.

Sektori financiar ka një rol të rëndësishëm në kapërcimin e situatës së krijuar nga COVID-19, i cili duhet të veprojë si një zinxhir i transmetimit të politikave fiskale dhe ekonomike të qeverive, duke krijuar mbështetje të ekonomisë reale me investime private, të forcojë rrjetin e sigurisë për bizneset dhe familjet, nëpërmjet policave të sigurimit dhe të nxisë e promovojë digjitalizimin e veprimeve me klientët, ku pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim, ende digjitalizimi i proceseve dhe produkteve paraqitet i pamjaftueshëm. Vlen të përmendim shoqëritë si: Apple, Facebook dhe Google, të cilat përdryshojnë metodat e të bërit dhe ofruarit shërbime bankare dhe sigurimesh. Nëse bankat duan të vazhdojnë t'i rezistojnë tregut, duhet të përshpejtojnë procesin e përshtatjes, ofrimit dhe zëvendësimit sa më shpejt të proceseve manuale me ato digjitale.

Vlen të përmendet gjithashtu edhe përdorimi i kursimeve private për të mbështetur e financiar bizneset dhe sektorin publik. Pavarësisht se sistemi ynë bankar paraqitet i qëndrueshëm



Pavarësisht se zhvillimi teknologjik ka ecur me ritme shumë të shpejta dhe jemi gjithnjë e më shumë të orientuar drejt digjitalizimit, ende taksimi vazhdon të bazohet dhe taksohet mbi të mira dhe aktive të prekshme. Rishikimi dhe identifikimi i formave të reja të taksimit, kryesisht për shoqëritë tregtare që operojnë në fushën e shërbimeve digjitale, duhet të zënë vend të rëndësishëm në politikat mbështetëse që qeveria duhet të ofrojë.



dhe shumë likuid, likuiditeti i tepërt është kosto oportune për bankat, është një fitim i munguar. Ndërkohë, likuiditeti mungon për individët që humbën vendet e punës dhe për ato biznese që kanë minimizuar apo pezulluar veprimtarinë ekonomike për shkak të pandemisë. Duhet që ky likuiditet të kanalizohet për të financiar zhvillimin ekonomik nëpërmjet instrumenteve financiarë, apo formave të ndryshme të bashkëpunimit. Instrumentet financiare dhe investimet alternative janë alternativa më e mirë për bankat që të investojnë likuiditetin e

tepërt. Jetësimi dhe përdorimi i instrumenteve financiarë kërkon njohuri specifike në fushën e financës dhe aftësi menaxheriale; për këtë është esenciale prania e sektorit bankar si ndërmjetës, konsulent dhe partner strategjik. Pavarësisht transformimit në sektorin bankar dhe ecurisë pozitive të rezultateve financiare që kanë pasur bankat gjatë këtyre viteve, në Shqipëri vazhdon të mbizotërojë një kulturë e dobët financiare.

Prania e Bursës Shqiptare të Titujve - ALSE ka pasur ndikim pozitiv në nxitjen dhe zhvillimin e kulturës financiare, por duhet që të vijohet sa më shpejt me listimin dhe tregtimin e obligacioneve dhe aksioneve të korporatave, apo dhe instrumenteve të tjerë, që ajo të ndikojë në lehtësimin e përthithjes së kapitalit për shumë biznese, por edhe mundësi investimi për të gjithë investuesit, si dhe në nxitjen e formalizimit të ekonomisë.

Në një fazë të kurrjes ekonomike, si ajo me të cilën po përballlet jo vetëm vendi ynë, por ekonomia botërore, është jetike të bëhet çdo përpjekje për të parandaluar transferimin e mëtejshëm të efekteve të pandemisë në ekonominë reale, duke krijuar ndikime të mëtejshme negative në familje, biznese dhe qeveri. Për qëllime të planifikimit financiar, në këtë periudhë të vështirë që po kalon ekonomia, duhet të përcaktohen dhe emetohen instrumente financiare, jetëgjatësia dhe sasia e të cilave duhet të përshtatet sipas karakteristikave dhe nevojave të tregut dhe kompanive. Referuar karakteristikave të vendit tonë dhe nivelit të rrezikut, mund të jetësoheshin instrumente të ndryshme, sipas tipologjive në

vijim:

- Financime me garanci qeveritare, me maturim afatmesëm. Efektet e krizës së shkaktuar nga pandemia dhe kostot përkatëse priten të materializohen në fund të vitit 2021, e për shumë familje dhe biznese situata financiare dhe mundësitë për të kapërcyer krizën, në periudhë afatshkurtër, nuk paraqitet shumë premtuese. Me qëllim nxitjen e kreditimit dhe për të siguruar vazhdimësinë e biznesit dhe ciklit ekonomik, është e nevojshme që të ofrohen garanci, për të minimizuar rrezikun dhe normën e interesit për financimet. Gjithashtu, mund të ofrohen njëkohësisht garanci për Leasing dhe Factoring, ky i fundit edhe pse në fazat fillestare të zbatimit në Shqipëri, paraqet potencial të lartë për tregun tonë.
- Financime rajonale, për të mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme nëpërmjet stimujve të ndryshëm fiskalë, ose grante për të promovuar rimëkëmbjen produktive. Këto financime mund të kontribuojnë në rilançimin e turizmit. E njëjta gjë vlen edhe për investimet në pasuritë e patundshme, që kanë për qëllim përmirësimin e zonave urbane dhe atyre të pazhvilluara.
- Kombinimi formave të financimit me grante.
- Subvencionimi i huave hipotekare për shtëpinë e parë, duke marrë në konsideratë edhe karakteristikat demografike dhe potencialin që ka vendi ynë.
- Financimi i Start-up-eve dhe Kapitalit Sipërmarrës, përmes pjesëmarrjes drejtpërdrejt në kapitalin aksionar, si një ndër

format më efikase të financimit për bizneset që kërkojnë kapital për të filluar biznesin, ose që ta zhvillojnë atë.

- Investimi në infrastrukturë si: autostrada, hekurudha dhe aeroporte, e cila është një formë e drejtpërdrejtë e mbështetjes ekonomike dhe është me rëndësi thelbësore për ekonominë, pasi do të lehtësonte shpenzimet publike dhe do të rriste konkurrencën midis firmave.

Pjesëmarrja e sektorit bankar në këto investime do të ishte përparësi për gjitha palët e interesuara. Këto janë investime që kërkojnë nivel të lartë kapitali dhe do të ishin eficiente në kuadër të një sistemi të prokurimit transparent dhe meritokratik, pasi në të kundërt kostot dhe pasojat negative në ekonomi do të ishin të konsiderueshme. Zhvillimi i investimeve alternative do të promovonte edhe rritjen e dërgesave nga shqiptarët që punojnë jashtë Shqipërisë. Pavarësisht se zhvillimi teknologjik ka ecur me ritme shumë të shpejta dhe jemi gjithnjë e më shumë të orientuar drejt digjitalizimit, ende taksimi vazhdon të bazohet dhe taksohet mbi të mira dhe aktive të prekshme. Rishikimi dhe identifikimi i formave të reja të taksimit, kryesisht për shoqëritë tregtare që operojnë në fushën e shërbimeve digjitale, duhet të zënë vend të rëndësishëm në politikat mbështetëse që qeveria duhet të ofrojë. Kjo është mundësia që na jepet të ri-startojmë ekonominë, duke u orientuar drejt modeleve të reja të biznesit, të cilat përkthehen në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social të vendit.

INTERVISTA

"...Industria bankare duhet të dëgjohet me të njëjtën forcë, si industria që ajo përfaqëson."

Është domosdoshmëri që të gjitha bankat të ecin në grup me qasjen se ne jemi në treg për të shtuar vlerë dhe për të dhënë shembullin e mirë për të gjithë industrinë e tjera ekonomike në vend.



Bledar SHELLA

Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave, AAB

Së pari, urime për zgjedhjen tuaj si Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave, AAB. Cili është mesazhi i parë që do dëshironi të jepnit për sektorin bankar në Shqipëri?

Ju falënderoj për përgëzimet!

Përgjatë gjithë viteve të karrierës sime si bankier e kam vëzhguar transformimin pozitiv të industrisë bankare, duke konstatuar me kënaqësi përmirësimin e mendësisë së

bankingut që ka ndodhur nga viti në vit. Si punonjës banke në pozicione drejtuese që herët në jetën time profesionale, kam kontribuar në rolet që kam pasur që banka të shërbejë vërtet si partner me të gjitha palët e përfshira, qofshin klientë, institucione, punonjës, etj.

Është domosdoshmëri që të gjitha bankat të ecin në grup me qasjen se ne jemi në treg për të shtuar vlerë dhe për të dhënë shembullin e mirë për të gjithë industrinë e tjera ekonomike në vend. Por, që kjo të arrihet në nivelet që pretendojmë, e para në radhë është forcimi i emrit të Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe dominimi i rolit të saj si bashkuese e të gjithë bankave në vend. Vetëm duke u bashkërenduar si industri, përmes veprimtarive dhe përfaqësisë së Shoqatës Shqiptare të Bankave, do mund të ndikojmë edhe në vendimmarrjet e institucioneve të tjera, të cilat krijojnë efekte madhore në sektorin bankar dhe në jetët e qytetarëve - klientë të bankave.

Cilat do të jenë prioritetet tuaja si Kryetar i AAB-së?

Në detyrën time si Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB), siguroj se do kem në vëmendje rigjallërimin e të gjitha komiteteve teknike të Shoqatës. Pas periudhës disi pasive të pandemisë, është e nevojshme që të gjitha funksionet mbështetëse të veprimtarisë së AAB-së të rikthehen në normalitet të plotë. Duhet të forcohen rolet e komiteteve dhe proaktiviteti i anëtarëve përkatës; të përmirësohen në tërësi të gjitha komitetet teknike, si nga pikëpamja e misioneve që mbartin dhe deri në rolet dhe detyrat e secilit kryetar dhe anëtarëve të tyre. Agjendat vjetore të të gjitha komiteteve duhet të jenë në mbështetje të situatës, misionit të AAB-së dhe të shtojnë vazhdimisht vlerë në kohë.

Nga ana tjetër, vet bankat duhet të jenë më të lidhura dhe të bashkëpunojnë më shumë me njëra-tjetrën, p.sh.: në çështje të tërthorta,

si: ofrimet e shërbimeve globale në treg (duke pasur përherë parasysh klientin të cilin shpesh e ndajmë mes bankash). Këtu do sillja si shembull shërbimin POS, lëvizjet e cash-it dhe sigurimin e tij, PSD2, transfertat, etj. Këto veprimtari kërkojnë investime të konsiderueshme dhe do ishte më mirë të shihen në nivel sektori dhe jo banke individuale. Për këtë arsye, e përherë duke aspiruar të mirën e përbashkët, është e udhës që bankat të pozicionohen si partnere të njëra - tjetrës dhe jo si konkurrenca. Duhet të pranojmë se konkurrenca e shëndetshme është e inkurajuar në çdo industri, pasi ajo nxit zhvillimin dhe investimet e vazhdueshme dhe, në fund, të gjitha palët janë të fituara, sidomos klientët tanë. Por, kur fjala vjen, në veprimtari si këto të mësipërmet, ku sinergjia do sillte vetëm të mira për të gjithë bankat, pse të mos bashkëpunohet mes bankash dhe kështu të ulen rreziqet, kostot dhe humbjet potenciale?

Bankat duhet të bashkëpunojnë për të thelluar më tej digjitalizimin, e në këtë çështje, AAB duhet të luajë një rol të rëndësishëm.

Një pikë tjetër me rëndësi është rritja e mëtejshme e zërit të AAB-së në marrëdhënie me institucionet dhe organizatat e tjera, si shtetërore, ashtu edhe private. Industria bankare është industria më e rëndësishme në vend dhe zëri i saj duhet të dëgjohet me të njëjtën forcë, si industria që ajo përfaqëson.

Nisur nga situata aktuale, sipas jush, cilat do të jenë sfidat më të mëdha me të cilën do të përballlet, në të ardhmen e afërt dhe të largët, sektori bankar në Shqipëri?

Sektori bankar, në tërësi, është i shëndetshëm dhe vërehet përmirësim nga viti në vit, si në treguesit e ecurisë, ashtu dhe në terma të investimeve teknologjike. Tashmë sistemi bankar ka një portofol të shëndetshëm kredie, likuiditet të bollshëm, si dhe një normë të lartë mjaftueshmërisë së kapitalit. Pandemia në vetvete rikonfirmoi dhe një herë qëndrueshmërinë e sektorit bankar, si dhe shpejtësinë për t'u përshtatur.

Në këndvështrimin tim, sfidat që tregu bankar shqiptar do duhet të përballlet, jo shumë vonë nga sot, lidhen me përshtatjen teknologjike dhe novatore, si dhe me edukimin e bazës së klientelës. Në kuadër të digjitalizimit dhe hyrjes në treg të Fintech-save, kryesisht në fushën e pagesave, bankat duhet të rishikojnë modelin e tyre të biznesit dhe të përshtaten.

Një tjetër sfidë është plotësimi i kuadrit rregullativ, i cili ndikohet nga përafrimi me BE-në. Ky kuadër rregullativ është mjaft angazhues dhe do të kërkojë burime të konsiderueshme nga bankat.

Optimizimi i proceseve, ulja e kohës së veprimit dhe historizimi i të gjithë veprimtarisë të klientëve me bankën do sjellë përmirësim të ecurisë së bankës kundrejt klientëve. Sa më shumë kohë

në dispozicion për produkte, shërbime dhe zgjidhje novatore, aq më shumë vlerë do shtohet në treg, për bankat dhe klientët. Deri tani kam përmendur bankat dhe klientët, por edhe përgatitja e forcës së punës, që do bëjë të mundur këtë valë ndryshimesh, është po aq vendimtare për sukses. Janë punonjësit tanë ata që sjellin në jetë projektet, trajnojnë njëri-tjetrin dhe edukojnë gradualisht klientët. Punonjësit tanë duhet të pajisen me dije të reja, ato që koha po dikton.

Si e shikoni në të ardhmen rolin e AAB-së?

Pozicioni i AAB-së në të ardhmen, sipas këndvështrimit tim, duhet dhe do jetë kyç në çuarjen përparatë krejt sektorit bankar, si dhe në rritjen e përmirësimin e marrëdhënieve me institucionet ligjvënëse, ligjzbatuese dhe institucioneve rregullatore në vend. Po aq i rëndësishëm është roli i AAB-së edhe në marrëdhënien me mediat dhe promovimin në tërësi të sektorit bankar. Vendi ynë vuan nga padija dhe mos-informimi për funksionet e bankave në treg, si dhe kultura e cekët financiare në tërësi. Është në misionin tonë si AAB të përhapim dijen, të forcojmë individin dhe patjetër që kështu do forcohet i gjithë komuniteti. Por kjo do bëhet e mundur vetëm nëse do jemi të gjithë bashkë, me të njëjtat parime dhe vlera drejtuese. AAB, bankat dhe palët e përfshira duhet të besojnë te njëri - tjetri dhe të përkrahin njëri - tjetrin.

Credins Bank hap dyert e saj në Kosovë

Vizioni i Bankës Credins është që të jetë pjesë e një rrjeti rajonal bankar, që vepron mbi parimet tregtare të ecurisë dhe qëndrueshmërisë, ndërkohë që njihet si banka që ofron shërbim bankar cilësor dhe kjo do të jetë risi në tregun e Kosovës, si dhe në çdo treg që strategjikisht do të vendoset që të zgjerohemi.



Selman LAMAJ

Drejtor i Përgjithshëm
CREDINS BANK, KOSOVË



Përparësitë konkurruese dhe ekspertizën që kemi krijuar për një shërbim të cilësor ndaj klientëve, portofolin e produkteve, sistemet teknologjike, rekrutimin dhe promovimin e stafit, do t'i zbatojmë edhe në Kosovë, për të ofruar më të mirën edhe në këtë treg.



me degë të reja në Prishtinë, e të vazhdojë më pas, me hapjen e degëve edhe në qytete të tjera.

Pandemia ishte sigurisht një fenomen frenues në proceset tona për hapjen e bankës tonë në Kosovë, por patëm një mbështetje të plotë nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), e cila me shumë profesionalizëm na udhëzoi në çdo hap gjatë proceseve që ndoqëm për marrjen e licencës si bankë e re në tregun e Kosovës. Kjo vendimmarrje e rëndësishme, edhe pse në kushtet me të vështira të pandemisë, nuk na ndali për të ecur përpara me planet dhe projektet tona për zgjerim të mëtejshëm dhe për të qenë të pranishëm në trojet shqiptare, afër çdo klienti. Banka Credins Kosovë zotërohet 100% nga Banka Credins Shqipëri, e cila po ofron të gjithë ekspertizën

dhe profesionalizmin e saj të akumuluar në vite edhe në tregun e Kosovës.

Strategjia afatmesme e Bankës Credins Kosovë në tre vitet e ardhshme ka për qëllim të forcojë pozicionin e saj si bankë, duke u mbështetur në disa shtylla kryesore, si: a) shërbime bankare novatore dhe të personalizuar, në përshtatje me sjelljen e konsumatorëve, b) investim në burimet njerëzore, c) rritje e produktivitetit në degët e saj, d) optimizimi i proceseve nëpërmjet jetësimit të sistemeve novatore.

Si vlerësohen mundësitë e zgjerimit të veprimtarisë në tregun financiar të Kosovës dhe cilat janë sfidat kryesore me të cilat po dhe do të përballlet Banka Credins?

Përpara pandemisë, Republika e Kosovës vijonte të përjetonte rritje ekonomike, që nga viti 2000. Kosova është një nga vendet e pakta në Europë me rritje ekonomike pozitive, që tregon një potencial shumë të madh zhvillimi në sistemin bankar. Sektori bankar në Kosovë është një prej shtyllave kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit, duke dëshmuar stabilitet dhe qëndrueshmëri ndër vite, si dhe duke financuar pa ndërprerje bizneset dhe ekonomitë familjare.

Përgjatë periudhës së pandemisë, si në çdo vend të botës, sfidë mbeti rimëkëmbja

Pse një zgjerim në tregun e Kosovës, sidomos gjatë një situatë komplekse si ajo e pandemisë COVID-19?

Banka Credins, pas 18 vitesh të suksesshme në tregun shqiptar, ka hapur dyert e saj në Kosovë. Tashmë sektorit bankar në Kosovë i shtohet një bankë e re. Banka Credins Kosovë ka lançuar veprimtarinë bankare, duke hapur në fund të 2020-ës, edhe pse një periudhë e vështirë pandemie, degët e saj të para në Prishtinë dhe në Ferizaj, dy degë që kanë investime moderne në komoditet për t'i ofruar klientit një shërbim cilësor bankar. Në planet afatshkurtra, zgjerimi i mëtejshëm do të vijojë me hapjen e degëve në Prizren, Pejë, Gjakovë,

ekonomike, kthimi në normalitet i shumë sektorëve të ekonomisë, të ndikuar negativisht nga pandemia, kthimi i besimit të individët për të rritur konsumin dhe investimet. Banka Credins Kosovë ka si pjesë të strategjisë së saj mbështetjen e ekonomisë, duke ofruar produkte financimi, si për individët ashtu dhe për bizneset, duke qenë mbështetëse në rimëkëmbjen e ekonomisë.

Sfidat e veprimtarisë në tregun financiar të Kosovës, tani kanë pësuar ndryshim. Normalja e re pas pandemisë mund të kërkojë masa shtesë dhe ri-formatim të strategjisë së planifikuar të biznesit, të cilat do të vlerësohen më tej. Gjithsesi, sot që flasim jemi më të mirë organizuar, në kuadër të eksperiencës bankare nga Banka Credins Shqipëri, për të përballuar efektet e shaktuara nga pandemia, si dhe duke mbajtur në vëmendje planet tona strategjike të zhvillimit të Bankës Credins Kosovë.

Çfarë mendoni se do ta diferencojë Bankën Credins nga bankat e tjera të pranishme në Kosovë?

Vizioni i Bankës Credins Kosovë është të ofrojë një shërbim bankar cilësor dhe të aplikojë produkte, apo infrastrukturë bankare novatore. Strategjia jonë e biznesit është e përqendruar në mbështetje të individëve, bizneseve mikro dhe të mesme, të cilat janë edhe më të prekurit nga pandemia. Bazuar në ekspertizën tonë bankare nga Banka Credins Shqipëri, kemi krijuar paketa specifike produktesh për grupe të caktuara klientësh, sipas nevojave të tyre, duke aplikuar gjithashtu

një politikë tërheqëse çmimesh. Të gjitha strategjitë e ndjekura nga Banka Credins Shqipëri deri më tani do të aplikohen për të jetësuar të gjithë produktet dhe shërbimet digjitale edhe në Bankën Credins Kosovë, përfshirë këtu strategjinë në risi dhe inovacion.

Misioni i Bankës Credins në Kosovë është të ofrojë shërbim cilësor ndaj klientit dhe të ndërtojë një biznes me njerëz të shkëlqyer, aktivë dhe vlera, që përmirësojnë standardin e jetesës. Banka Credins në Kosovë do të jetë një bankë e integruar, e fokusuar në inovacion. Duke krijuar një strategji efektive të shitjeve, banka do të ofrojë produkte dhe shërbime konkurruese, si dhe do të krijojë fushata tërheqëse marketing. Për të përmbushur misionin e saj, Banka Credins Kosovë do të operojë mbi bazën e disa objektivave strategjike, që janë shtyllat kryesore ku do të mbështetet, si: ndërtimi i një kulture pune motivuese, zbatimi i procedurave fleksibël për një shërbim eficient ndaj klientëve, ofrimi i një pakete të plotë produktesh dhe shërbimesh bankare, futja e shërbimeve novatore, si dhe një shërbim i personalizuar konsulence dhe mikpritje nga çdo staf e në çdo degë të bankës.

Përparësitë konkurruese dhe ekspertizën që kemi krijuar për një shërbim të cilësor ndaj klientëve, portofolin e produkteve, sistemet teknologjike, rekrutimin dhe promovimin e stafit, do t'i zbatojmë edhe në Kosovë, për të ofruar më të mirën edhe në këtë treg. Banka Credins Kosovë do jetë një pjesëmarrëse aktive në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës, duke mbështetur

planet e investimeve të bizneseve vendase, ose të huaja. Mbi të gjitha, nëpërmjet shtimit dhe zgjerimit të rrjetit të degëve në Kosovë, do të krijojmë hapësira për punësim dhe zhvillim të talenteve të reja, duke ndërtuar një kulturë korporative që promovon karrierën dhe potencialin e tyre, duke ndërtuar një ekip të fortë dhe me njerëz të talentuar.

Se fundmi, Banka Credins Kosovë do të ndërtojë një kulturë korporative, në mbështetje të komunitetit, duke përkrahur projekte që kanë lidhje me edukimin, mjedisin, luftën ndaj varfërisë etj., pasi besojmë se duke u zhvilluar së bashku arrijmë të jemi të suksesshëm. Gjithashtu, rritja dhe praktikatat e mira bankare do të kenë mbështetjen nga Banka Credins Shqipëri duke siguruar që banka e re në Kosovë të ketë përshtatje shumë të mirë në treg.

A do të jetë Kosova stacioni i fundit i Bankës Credins në rajon, apo vetëm i pari? A ka banka një strategji rajonale të shtrirjes së veprimtarisë?

Besojmë se është i pari. Kemi studiuar edhe vende të tjera të rajonit, si: Maqedonia, por patjetër Kosova do të ishte e para, të cilën e finalizuam me sukses. Në të ardhmen, pse jo, edhe zgjerimi në vendet e Perëndimit. Vizioni i Bankës Credins është që të jetë pjesë e një rrjeti rajonal bankar, që vepron mbi parimet tregtare të ecurisë dhe qëndrueshmërisë, ndërkohë që njihet si banka që ofron shërbim bankar cilësor dhe kjo do të jetë risi në tregun e Kosovës, si dhe në çdo treg që strategjikisht do të vendoset që të zgjerohemi.



SHTËPIA IME

ZBULO PRONËN PERFEKTE PËR TY

- ☑ **26** agjenci real estate të përfshira në aplikacion
- ☑ **500+** prona nga e gjithë Shqipëria

Shkarko këtu ↓



**Raiffeisen
BANK**

Pjesë e Grupit RBI

Kriza e Covid-19: Mbikëqyrja bankare përballë pasigurisë ekstreme

Pyetja që ngrihet aktualisht nuk është nëse do të rritet raporti i huave me probleme në banka, por sa do të rriten ato.



Gonzalo GASOS

Drejtor i lartë i Mbikëqyrjes & Politikave Prudenciale
FEDERATA EVROPIANE BANKARE,
EFB-FBE

Gjatë krizës së COVID-19, dy ishin çështjet më të mprehta, nga të cilat njëra shërbeu si shkak për tjetrën: kompleksiteti dhe pasiguria. Me korona virusin, qeveritë në të gjithë u përballën me një situatë në evoluim e sipër, dhe Evropa nuk përbënte përjashtim nga ky rregull. Kompleksiteti çoi në pasiguri. Në vijim u fituan njohuri të reja rreth virusit, u testuan strategji të ndryshme kundër tij, e madje edhe tani ekziston shqetësimi rreth varianteve të reja të virusit. Kompleksiteti dhe pasiguria e situatës ka përfshirë edhe fushën e shërbimeve financiare, ku zhvillohen shumë nga debatet kryesore, lidhur me



Veçantia e krizës COVID-19 qëndron në faktin se, pagesat e pakryera nga huamarrësit, ose masat për shtyrjen e pagesave, nuk janë domosdoshmërisht tregues i dështimit të biznesit.



COVID-19. Për sa i përket rrezikut të kredisë, fokusi u zhvendos shpejt drejt huave me probleme (NPL), që supozohet se do të pasojnë krizën e COVID-19. Përhapja e COVID-19 demonstroi vlerën e përshtatjes së shpejtë me ndryshimin e rrethanave, gjithashtu edhe në fushën e mbikëqyrjes bankare.

Menaxhimi i krizës gjatë periudhës së krizës

Duke parë situatën e sektorit bankar dhe ndikimin e COVID-19 në rrezikun e kredisë, objektivi kryesor, i identifikuar nga grupet publike dhe private të interesit, ishte mbështetja e ekonomisë dhe shmangia e një krize ekonomike. Kjo shpjegon nismat e shumta nga qeveritë kombëtare, që ofruan garanci publike për bizneset në vështirësi, por edhe



Lukas BORNEMANN

Këshilltar Politikash
Mbikëqyrja & Politikat Prudenciale
FEDERATA EVROPIANE BANKARE,
EFB-FBE

brenda komunitetit bankar, ku rregullatorët dhe industria kërkojnë marrjen e masave për të zbutur ndikimin e COVID-19 dhe për t'u siguruar që bizneset dhe ekonomitë familjare nuk do të kalonin në paaftësi paguese, si viktimat e një fatkeqësie të tillë. Përkundër këtij sfondi, EBF u rekomandoi¹ grupeve të interesit në BE zbatimin e moratoriumit për huamarrësit në vështirësi, për shkak të COVID-19. Këto moratoriume, që lejuan shtyrjen e pagesave nga ekonomitë familjare dhe bizneset pa përkeqësim të statusit të tyre, u miratuan pak më vonë nga EBA, në formën e Udhëzimeve² dhe u zbatuan vetëm për huat e dhëna

¹ EBF Press Release, 11 March 2020: EBF letter calls for European measures to face Covid-19 outbreak,

² EBA Guidelines on legislative and non-legislative moratoria on loan repayments applied in the light of the COVID-19 crisis.

që nga shpërthimi i COVID-19. Ndërkohë që kriza po zgjerohet më tej, periudha fillestare 3 mujore për aplikimet e moratoriumit u zgjat, fillimisht deri në shtator 2020 dhe, së fundi, deri në mars 2021. Përveç moratoriumit, masat e tjera prudenciale i ndihmuan bankat dhe klientët e tyre të përballonin problemet gjatë vitit 2020³, përfshirë këtu edhe aktivizimin e filtrave prudencialë në kuadër të SNRF 9, parashikimin e faktorëve mbështetës dhe elementët e Shtyllës së Dytë, të parashikuar në CRR2, sikundër dhe elementë të tjerë, që synonin reduktimin e prociklikalishtetit, të cilat do të kufizonin ofertën e kredisë për ekonominë.

Çfarë vjen më pas: davaritja e kompleksitetit

Parashikimi i fundit ekonomik nga Komisioni Evropian tregon për një ringjallje ekonomike të Eurozonës, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021⁴. Ndërkohë që veprimtaria ekonomike mund të kthehet në normalitet, do të ketë gjithsesi edhe disa të panjohura, të cilat duhet të merren parasysh. Një prej tyre është sasia e huave me probleme që duhet të adresohen, pasi të ketë kaluar kriza. Në vitin 2020, BQE vlerësoi se huat me probleme mund të arrinin në 1.4 trilionë euro, si pasojë e krizës së COVID-19. Gjithsesi, e vërteta është se vala e madhe e huave me probleme nuk është materializuar ende. Siç deklaroi dhe BQE në Raportin e Stabilitetit Financiar nga maji 2021, ekonomia provoi të ishte më e qëndrueshme se sa pritej, por rimëkëmbja mbetet e brishtë⁵. Fokusi i muajve të ardhshëm do të jetë mbi huat që së shpejti mund të

klasifikohen si problematike. Edhe pse huat me probleme nuk janë rritur ende në një shkallë të gjerë, tashmë ka shenja për rritjen e përkeqësimit të cilësisë së aktiveve që lidhen me huat, që kanë lëvizur nga Kategoria 1 në Kategorinë 2⁶, një shenjë paralajmëruese dhe një kampion për rritjen në të ardhmen të huave me probleme. Pyetja që ngrihet aktualisht nuk është nëse do të rritet raporti i huave me probleme në banka, por sa do të rriten ato. Kjo të çon në sfidën tjetër, e cila lidhet me përpjekjet e bankave për të identifikuar bizneset që mund ta kapërcejnë krizën dhe të punojnë me to për ristrukturimin e detyrimeve. Sidoqoftë, sipas legjislacionit aktual të BE-së, bankat detyrohen t'i konsiderojnë këta huamarrës si në pamundësi për të paguar, për shkak të shtyrjes së përkohshme të ripagesave.

Për shkak të krizës COVID-19, e cila nuk ishte një goditje e zakonshme për ekonominë, do të jetë e rëndësishme të sigurohet që huat e bizneseve, që kalojnë në klasifikimin si problematike, të jenë në fakt ato të duhurat. Këtu ka rëndësi fakti që të shmangët klasifikimi i huave të bizneseve të shëndetshme në kategorinë e huave me probleme, me të gjitha pasojat negative që do të sillte ky klasifikim. Veçantia e krizës COVID-19 qëndron në faktin se, pagesat e pakryera nga huamarrësit, ose masat për shtyrjen e pagesave, nuk janë domosdoshmërisht tregues i dështimit të biznesit. Kuadri rregullator kërkon që bankat të zbatojnë të gjitha kriteret për identifikimin e huave me probleme. Ndërkohë që në kushte normale ato do të justifikonin klasifikimin

e tyre si hua me probleme, sot në kushtet aktuale ato mund të ndikojnë fort mbi bizneset, të cilat parimisht do kishin një veprimtari të shëndetshme. Gjithsesi, gjatë pandemisë COVID-19 pati një mbyllje të detyruar të veprimtarisë ekonomike. Ekonomia, në pjesën më të madhe, u vendos në gjendje "pauze". **Humbja, në këtë kontekst, nuk është domosdoshmërisht tregues se biznesi është ose jo i shëndetshëm.** Duke u dhënë kohë dhe fleksibilitet të mjaftueshëm, shumë biznese mund të jenë në gjendje të gjenerojnë fitime, për të shlyer detyrimet e tyre. Kjo është thelbësore, pasi klasifikimi i huave si problematike e bën shumë më të vështirë sigurimin e financimeve për bizneset në fjalë dhe përfundimisht çon në dështim të tyre. Për më tepër, provizionet për humbjet nga huat dhe rritja e kërkesave për kapital mund të kufizojnë huadhënien për ekonominë. Të dy këta faktorë mund të amplifikojnë goditjen ekonomike të krizës së COVID-19.

Zgjidhjet: Përgatitja për të panjohurën

Për portofolin ekzistues të huave me probleme dhe ato që duhet të klasifikohen si të tilla, sfida është gjetja e strategjisë së duhur për t'i zvogëluar ato. Në dhjetor 2020, Komisioni Evropian prezantoi Planin e Ri të Veprimit për Huat me Probleme⁷ i cili ndihmon në trajtimin e këtyre çështjeve. Fokusi i planit të veprimit të Komisionit Evropian për huat me probleme është fuqizimi i tregjeve dytësore për huat me probleme. Nga pikëpamja prudenciale, tre janë masa veçanërisht interesante, si:

³ Regulation (EU) 2020/873 amending Regulations (EU) No 575/2013 and (EU) 2019/876 as regards certain adjustments in response to the COVID-19 pandemic.

⁴ European Commission, Spring 2021 Economic Forecast.

⁵ European Central Bank, Financial Stability Review, May 2021.

⁶ European Central Bank, Financial Stability Review, May 2021.

⁷ Action plan: Tackling non-performing loans (NPLs) in the aftermath of the COVID-19 pandemic.

1) zbutja e pengesave rregullatore lidhur me tregjet dytësore për huat me probleme, 2) mbështetja e titullizimit të huave me probleme, 3) promovimi i përdorimit të kompanive të menaxhimit të aktiveve (AMC).

Propozimet në planin e veprimit të NPL-ve, gjithashtu, reflektojnë në një farë mase strategjitë që bankat kanë në dispozicion për të zgjidhur çështjet e NPL-ve. Për të ulur NPL-të, bankat mund të mbështeten në mjetet e mëposhtme: 1) proceset e brendshme të punës/ristrukturimi, 2) shitjet e drejtpërdrejta të portofolave të NPL-ve, 3) titullizimi 4) platformat e tregtimit, 5) AMC-të. Përveç zgjidhjeve të brendshme natyrore, të gjitha strategjitë e tjera do të mbështeteshin nga objektivat e propozimeve të Komisionit Evropian. Heqja e pengesave rregullatore për shitjet

dhe blerjet e NPL-ve, në këtë kontekst, mund të adresonte një mospërputhje në këtë kuadër, e cila pengon bankat nga kontabilizimi i rregullimeve specifike të kredisë, të tilla si: fshirjet nga bilanci, që nuk janë bërë nga vetë banka. Kjo është një pengesë shtesë për institucionet bankare të përfshira në blerjet e NPL, e cila duhet të kapërcehet. Titullizimi i NPL-ve është një mjet i dobishëm për heqjen e NPL-ve dhe prandaj nisma e Komisionit Evropian është në kohën e duhur. Duke marrë parasysh që në vitet e kaluara, skemat e mbështetjes si GACS italiane, ose Hercules Greke kanë qenë shumë të rëndësishme për tregjet e NPL-ve, për mbështetjen e mëtejshme rregullatore mund të krijojë titullizimet e NPL si një mjet i përshtatshëm, në mungesë të atyre skemave. Një hap i parë

është bërë me botimin e Paketës së Rimëkëmbjes të Tregjeve të Kapitalit, por duhet të punohet më tej për të përmirësuar ndjeshmërinë ndaj rrezikut dhe për të llogaritur ekspozimet që nuk ka gjasa për të paguar, të cilat nuk janë mbuluar ende nga rregullat e titullizimit. Nisma në temën e AMC është e lavdërueshme, por në përgjithësi zgjidhjet e sektorit privat duhet të preferohen për arsye efikasiteti. Në përgjithësi, Plani i Veprimit të Komisionit Evropian do të zgjerojë rutinë e mjeteve për të trajtuar portofolin e NPL-ve, që do të vijë së shpejti. Sidoqoftë, nuk duhet harruar se krahas madhësisë të NPL-ve të ardhshme, ajo që ka më shumë rëndësi është përbërja e tyre, duke pasur parasysh prospektin e vazhdimësisë së biznesit për huamarrësit e qëndrueshëm.





Platforma e re digjitale e Tirana Bank!

Shkarkoje tani!



tiranabank.al

 **TIRANA BANK**

KËTU PËR JU

Superekipet: “Inteligjenca Artificiale në grupe”

Nëse të gjithë aktorët në një ekonomi punojnë në sinergji, atëherë mund të themi se ka një klimë të favorshme për përqaftimin e kësaj teknologjie të sofistikuar dhe domosdoshmërisht të dobishme për sigurimin e qëndrueshmërisë së biznesit.



Roden PAJAJ

Drejtor i Burimeve Njerëzore për
DELOITTE EVROPË QENDRORE - JUGORE
Dhe për Shërbimet e Konsulencës së Kapitalit
Njerëzor në DELOITTE SHQIPËRI & KOSOVË

Në vërtetimin e Deloitte mbi prirjet e kapitalit njerëzor në Shqipëri për vitin 2020, një nga prirjet kryesore u shfaq përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në punën e ekipeve, duke i kthyer ato në “superekipe”. Një nga ndikimet e pandemisë COVID-19 ishte dhe shkrirja e kufijve mes punës dhe jetës, veçanërisht për punonjësit në distancë, ndërkohë që punonjësit në frontin e parë, duken më të ngarkuar se më parë. Kjo është dhe një nxitës tjetër që organizatat t'i adresojnë këto zhvillime duke ri-imagjinuar mënyrën e mbështetjes dhe fuqizimit të forcave të punës, nëpërmjet teknologjisë. Për fat të mirë, kjo nevojë urgjente koincidon dhe me spektrin gjithnjë


e në zgjerim ku po gjen zbatim IA, kryesisht në vendet e zhvilluara, në përmirësimin e proceseve të punës në tërësi. Në veçanti, kjo prirje përfshin alternativat që ofron IA, jo vetëm në proceset e punës, por dhe në integrimin e saj në punën e përditshme dhe në menaxhimin e fuqisë punëtore, si dhe mirëqenies së saj.

Kjo teknologji po mundëson përdorimin e robotëve folës (chatbots) dhe të asistentëve digjitalë me aftësi bashkëbisedimi, duke krijuar përvoja për punonjësit, të cilat tejkalojnë atë çfarë njerëzit të vetëm mund të ofrojnë¹. Këto mjete mund të shndërrojnë rrënjësisht ndërveprimet në mjedisin e punës, të automatizojnë procese administrative, të identifikojnë sjelljet e dëshiruara e gjithashtu të mundësojnë të dhëna specifike që ndihmojnë vendimmarrjen e biznesit.

Hendeku Rëndësi - Gatishmëri

Rreth 63% e pjesëmarrësve në vërtetimin pohojnë se prirja “Superekipet: Inteligjenca artificiale në grupe” është e rëndësishme, ose shumë e rëndësishme në suksesin e kompanisë, por vetëm 27% e tyre shprehen se janë gati për ta adresuar këtë prirje.

Me gjithë aplikimin e shtuar në shumë vende të botës, Shqipëria duket ende larg integritit të IA-së. Duke parë se 63% e pjesëmarrësve në vërtetimin e shohin atë me rëndësi për suksesin e organizatës së tyre, mund ta konsideronim një zhvillim shpresëdhënës. Megjithatë, vetëm 27% pohojnë se organizatat janë të përgatitura për aplikimin e saj në proceset e tyre në 2-3 vitet e ardhshme, një nivel gatishmërie ky më i ulët në raport me prirjet e tjera për vitin 2020.²



¹ “Deloitte’s State of AI in the Enterprise”, 3rd Edition [The state of artificial intelligence in business | Deloitte Insights](https://www2.deloitte.com/al/sq/pages/human-capital/solutions/trendet-e-kapitalit-njerëzor-2020.html)

² Deloitte Albania, Raporti mbi Trendet e Kapitalit Njerëzor, 2020, “Ndërmarrja sociale në veprim: Paradoksi si një formë zhvillimi” <https://www2.deloitte.com/al/sq/pages/human-capital/solutions/trendet-e-kapitalit-njerëzor-2020.html>



Përgjithësisht, në të gjitha pyetjet e vrojtimit, të cilat i adresoheshin IA, rezultojnë një numër relativisht i ulët përgjigjesh, krahasuar me rubrikat e tjera. Kjo mund të lidhet me nivelin e ulët të gatishmërisë së organizatave për aplikimin e saj, apo edhe me kuptueshmërinë mbi zbatimin praktik të kësaj prirje. Gjysma e pjesëmarrësve në vrojtimit shprehën se nuk përdorin aktualisht IA, dhe pjesa tjetër është duke shqyrtuar, apo pilotuar mënyra për përdorimin e saj.

Për ta zbatuar gjerësisht, nevojitet një ekonomi e cila funksionon në sinergji dhe e nxitur nga domosdoshmëria për zbatimin e saj. Do të duhej puna e koordinuar e shumë aktorëve të tregut, përfshirë këtu institucione publike dhe private, si dhe investime të konsiderueshme në kërkim dhe zhvillim. Në këto kushte, me përballjen e pashmangshme të tregut shqiptar me IA në të ardhmen, organizatat shqiptare duket se po bëjnë lëvizjet e para për ri-afhtësimin e forcës së tyre të punës.

Rreth 38% e tyre shprehën se po investojnë në nivel të moderuar në ri-afhtësimin e punonjësve, ndërsa më pak se një e katërta pohojnë se janë duke kryer investime të konsiderueshme në këtë drejtim (23%). Po aq pohojnë se po kryejnë ndërhyrje në buxhetet e caktuara për mësim dhe zhvillim, për të njëjtin qëllim. Megjithatë ende në faza të hershme, ky duket një zhvillim premtues për të përgatitur tregun për sfidat e ardhshme.

Nga ana tjetër, është ende herët në rastin e Shqipërisë, për të vlerësuar ndikimin që mund të ketë IA në rritjen e papunësisë në vend, si pasojë e zëvendësimit të njeriut në kryerjen e proceseve të punës, një debat i nxehtë dhe aktual në vend të zhvilluara.

Dukshëm vërehet se numri i



punëve të cilat kërkojnë aftësi të kombinuara do të ndryshojë, pasi në fund të fundit, përdorimi i IA-së do të kërkonte, më së shumti, aftësitë tipikisht njerëzore, si: të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, krijimtaria, bashkëpunimi dhe ndërveprimi njerëzor.

Marrë të gjitha së bashku, kompanitë në Shqipëri kanë ende sfida për t'u përballur me ndryshimet e së ardhmes. Disa nga qasjet e domosdoshme për adresimin e tyre mund të ishin:

a) Vlerësimi i nevojës për adoptimin e IA-së jo vetëm në përmirësimin e shërbimeve dhe të kujdesit ndaj klientëve, por edhe në vet mënyrën se si kryhet puna, e veçanërisht në përmirësimin e punës në ekip.

b) Rritja e qëndrueshme e investimeve në aftësim dhe ri-afhtësim, menaxhimin e njohurive dhe ekspertizës së krijuar në organizatë, si dhe në mbajtjen e forcës së tyre të punës.

c) Bashkëpunimi, në frymën e partneritetit, për krijimin e një ekosistemi ku kompanitë e kanë më të thjeshtë të shkëmbejnë përvoja, njohuri dhe talente midis tyre.

Nëse të gjithë aktorët në një ekonomi punojnë në sinergji, atëherë mund të themi se ka një klimë të favorshme për përqaftimin e kësaj teknologjie të sofistikuar dhe domosdoshmërisht të dobishme për sigurimin e qëndrueshmërisë së biznesit.

Digjitalizimi dhe Posta Hibrade: Transformimi i shërbimit postar dhe financiar shqiptar, jo-bankë

Hedhja në treg e aplikacionit të pagesave online “e-Posta”, apo shërbimit e-Wallet, i cili mund të krijohet në çdo zyrë postare në vend, nuk duhet të shihet thjesht si një alternativë tjetër në tregun e bankingut, por si një mundësi dhe moment emergjent, për të edukuar dhe ndryshuar sjelljen e konsumatorit edhe për ato segmente tregu të paarrtshëm më parë nga sektori bankar dhe financiar shqiptar.



Gjergji HAMITI

Drejtor i Drejtorisë së Marketingut
POSTA SHQIPTARE SH.A.

Revolucioni teknologjik, që ka nisur prej disa dhjetëvjeçarësh, nuk ka më një objekt final, por është shndërruar në një proces evolutiv transformimi për gjithë ekosistemin e novatorëve. Nga ana tjetër, pandemia thjesht sa rriti vrullin e këtij procesi, duke bërë që edhe në vende me kulturë dhe sjellje konsumatore më tradicionale dhe konservatore ndaj status-quo së kërkesës së tregut, të mos jetë e vështirë hapja drejt proceseve digjitalizuese. Janë këto ndryshime epokale që kanë ndikuar në përparimin e njerëzimit dhe zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së përditshme, duke përfshirë mënyrën e jetesës,

të komunikimit dhe pse jo edhe mënyrës së të bërit biznes. Si rrjedhojë, këto zhvillime në sferën e ekonomisë botërore dhe tregjeve globale kanë ndikuar padyshim edhe vizionet dhe strategjitë e korporatave lokale për të ardhmen.

Në vendin tonë, rasti më klasik i kësaj sfide është ai korporatës më të madhe dhe të vjetër shqiptare të shërbimeve postare dhe financiare jo-bankë: POSTA SHQIPTARE. Në kohë pandemie kjo korporatë riktheu vemendjen e qytetarëve, biznesit dhe institucioneve për rëndësinë e saj strategjike, në një moment kritik për vendin. Përmes shtrirjes dhe kapaciteteve të saj shpërndarëse, në një hark kohor prej vetëm 3-4 muaj, postierët arritën të shpërndanin rreth 1.5 milionë pensione në banesa. Ky shërbim vazhdon të kryhet edhe sot për 160 mijë pensionistë, përkundrejt një tarife shërbimi të bazuar në kosto. Gjithsesi, cilado qoftë fuqia e shtrirjes territoriale, kapacitetet e saj logjistike dhe vet pësia e Posta Shqiptare për konsumatorin vendas, kjo nuk mjafton, nëse do të mbash “pjesën e luanit” në treg në këtë epokë evolucionit. Vizioni për hedhjen në treg të aplikacionit për kryerjen e pagesave elektronike: “e-Posta”, platformës tregtare: “Posta Retail Outlet” dhe së fundi edhe futja e teknologjisë së Postës Hibrade, e ka bërë këtë subjekt 109 vjeçar



Vizioni për hedhjen në treg të aplikacionit për kryerjen e pagesave elektronike: “e-Posta”, platformës tregtare: “Posta Retail Outlet” dhe së fundi edhe futja e teknologjisë së Postës Hibrade, e ka bërë këtë subjekt 109 vjeçar të ripërtërihet, duke iu përgjigjur ofertës ndaj tregut në zhvillim, por njëkohësisht të ruajë edhe themelet e vazhdimësisë e tij.



të ripërtërihet, duke iu përgjigjur ofertës ndaj tregut në zhvillim, por njëkohësisht të ruajë edhe themelet e vazhdimësisë e tij.

Por sa e lehtë është për një korporatë të ashtuquajtur tradicionale kjo përshtatje e re, në një treg pjesërisht tradicional? Sipas Sondazhit Global të Findex, më pak se 7 % e shqiptarëve raportojnë se kanë përdorur internetin për të blerë një produkt në këtë platformë, gjatë vitit 2019. Por, ndonëse nuk kemi një shifër konkrete për vitin që lamë pas, mendohet se në 2020 dhe 2021, kjo përqindje është rritur ndjeshëm për vetë arsyen se pandemia solli në vemendjen e të gjithëve rëndësinë e proceseve digjitalizuese, pagesave

Faleminderit

që na zgjodhe si partnerin
tënd të besueshëm për të
arritur majat.



dhe transaksioneve online, si dhe përparimin e mëtejshëm në blerjet dhe tregtinë elektronike (e-commerce).

Ajo i dha fund dilemës së kompanive tradicionale shqiptare për ndryshim të mënyrës së orientimit të tyre ndaj tregut dhe konsumatorit. Përballë kësaj krize ekonomike dhe shëndetësore, siç ishte COVID-19, e ndikuar edhe nga kufizimet e veprimtarive ekonomike dhe ndalimit të shërbimeve postare ndërkombëtare, Posta Shqiptare, pa asnjë mëdyshje, e kapi momentin, duke u fokusuar më së shumti në tregun e brendshëm postar e financiar, si dhe nxiti investimin në vizionin e saj për të konsoliduar infrastrukturën digjitale dhe të tregtisë elektronike.

Investimet në platformën Gateway u lejon palëve të treta (që janë kryesisht institucione financiare dhe banka) të lidhen në mënyrë të sigurt me sistemin e Postës Shqiptare. Nëpërmjet 533 zyrave postare në të gjithë vendin, shërbimet bankare kanë mundësi të penetrojnë edhe në zonat më të thella të Shqipërisë, ku bankat tregtare, apo institucionet mikro-financiare nuk kanë mundur të jenë më parë të pranishëm.

Sot mund të kryesh transferta cash-to-cash brenda dhe jashtë vendit, me komisionet më të ulëta në treg, edhe në zyrën postare më periferike të vendit, të aplikosh për marrjen e një mikro-kredie, të bësh disbursim fondi, apo të arkëtosh këste kredie në lekë, apo euro, për banka tregtare, sipas marrëveshjeve të Posta Shqiptare me këto institucione financiare. Nga ana tjetër, pajisja me licencën e parasë elektronike nga Banka e Shqipërisë i hap rrugën e këtij institucioni drejt zgjerimit të ofertës për konsumatorin, përmes një pakete edhe më të gjerë shërbimesh bankare, siç është krijimi i portofolit

e-Wallet për çdo klient të saj.

Hedhja në treg e aplikacionit të pagesave online "e-Posta" nga Posta Shqiptare për t'u ardhur në ndihmë klientëve individë/biznes në kryerjen pagesave utilitare (ujë, energji elektrike, tatime, dogana dhe gjoba) nëpërmjet kartës bankare, apo shërbimit e-Wallet, i cili mund të krijohet në çdo zyrë postare në vend, nuk duhet të shihet thjesht si një alternativë tjetër në tregun e bankingut, por si një mundësi dhe moment emergjent, për të edukuar dhe ndryshuar sjelljen e konsumatorit edhe për ato segmente tregu të paarrtshëm më parë nga sektori bankar dhe financiar shqiptar. Ky aplikacion i shërben qytetarëve dhe biznesit për të kryer pagesa në kohë reale, pa komision transfertash, për disa shërbime utilitare, ose me komisionet më të ulëta në treg për disa të tjerë. Njëkohësisht ai gjurmon në kohë reale edhe objektet postare, duke mos ofruar thjesht shërbim financiar, por edhe postar.

Sot, një qytetar që deri dje mbante radhë me librezën e energjisë elektrike në dorë pranë një zyre postare, duke humbur kohë dhe rrezikuar madje të infektohet nga virusi famëkeq, ka mundësi që këtë shërbim ta bëjë vetëm me një klik, përmes aplikacionit mobile që mund të shkarkohet falas në platformën App Store, apo Google Play, nga çdo smartphone. Për të përmbyllur të gjithë ciklin e infrastrukturës së tregtisë online, Posta Shqiptare ndërtoi platformën e tregtisë elektronike të dyqanit online: "Posta Retail Outlet", ku përpos saj në ndihmë të biznesit vjen edhe magazina doganore e sapo kompletuar, një hapësirë e madhe stoku për ato shoqëri që kërkojnë lehtësitë e duhura për minimizimin e kohës dhe kostos së shpërndarjes së produkteve të tyre, në tregun vendas dhe atë rajonal.

Së fundi, jetësimi i konceptit të Postës Hibride është një tjetër aspekt novator, i cili është një shërbim elektronik postar që ndërthur postën e thjeshtë me postën elektronike, duke e ngritur shërbimin ndaj tregut në një nivel tjetër. Mjafton që materiali t'i dërgohet zyrës postare ku ka adresën pritësi, në Shqipëri ose jashtë saj, nëpërmjet postës elektronike (e-mail) dhe mandej ai përpunohet nga makineria dhe konvertohet në objekt postar. Një ndër aspektet e parapëlqyera që ky shërbim i teknologjisë së lartë ofron për biznesin, duke i kursyer atij kohë dhe para, është ai i lëshimit të faturave. Me të dërguar të dhënat përmes postës elektronike, të dhënat e faturës rregullohen, printohen dhe vendosen në zarf, e më pas shpërdahen në destinacionin final. Kjo makineri e teknologjisë së lartë ka kapacitet printimi prej 140 mijë fatura në 24 orë. Me fjalë të tjera, Posta Hibride bashkon fizikisht edhe në formë digjitale shitësin dhe blerësin, biznesin dhe konsumatorin, shtetin dhe qytetarin, duke e transformuar komunikimin ndërmjet tyre në një standard bashkëkohor.

Shprehja se: "E ardhmja i përket e-commerce", nuk është më një nocion futurist; tashmë ai është realitet në skenën e arenës globale. Ndërkohë, pandemia e përshpejtoi këtë realitet, duke treguar se konsumatori, edhe ai më tradicional, arrin të përshtatet shpejt e madje me ritme mbresëlënëse. Ndaj sot, sfida e çdo sipërmarrje të vogël, apo korporate gjigande, nuk mund të jetë peng i burokracive, apo mentalitetit konvencional. Ajo duhet të përqafojë me kurajo misionin novator, edhe në momentet më të vështira. Vetëm vizioni për t'u përshtatur me këtë treg në zhvillim do të mund të na nxjerrë në ujëra të qeta, në të kundërt do të mbetemi pas si një relike e gëlltitur nën oqeanin e historisë.

Tregu i kriptomonedhave dhe politika monetare

Qeveritë po konkurrojnë me tregjet e kriptomonedhave; ato do të duhet të krijojnë CBCD-të e tyre për të mbajtur monopolin mbi furnizimin e parave.



Prof. Dr. Agim KUKELI

Departamenti Bankë-Financë
UNIVERSITETI "EPOKA"

"Në planin afatgjatë të gjithë kemi vdekur. Ekonomistët nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se të na tregojnë që pasi stuhia kalon, oqeani është i qetë." Keynes na ngushëllon për t'u kapur pas pyetjes se si tregu i kriptomonedhave do të ndikojë në politikën monetare dhe si do të duket e ardhmja e tij. Duke parë faqen e internetit të "CoinDesk" ne gjejmë informacione mbi tregun e kriptomonedhave. Të dhënat nga kjo faqe tregojnë se pjesa më e madhe e tregut është e mbuluar nga vetëm dy kriptomonedha.




Dr. Nertil MERA

Departamenti Bankë-Financë
UNIVERSITETI "EPOKA"

Cështja e efektit që kriptomonedhat do të kishin në politikën monetare nuk është një detyrë e lehtë për t'u trajtuar. Ballafaqimi me politikën monetare tradicionale dhe efektet që kriptomonedhat do të kenë mbi të, do të thotë t'i përgjigjesh pyetjes lidhur me efektin që kriptomonedhat dhe tregjet e tyre përkatëse do të kenë në ofertën monetare, së bashku me vendimet që familjet dhe firmat do të marrin për mbajtjen e parave të gatshme, kundrejt blerjes së instrumenteve financiare (borxhi ose kapitali, tregu i parave apo instrumentet e tregut të kapitalit), vendimet që agjentët e tjerë do të marrin në lidhje me huamarrjen dhe politikën fiskale në përgjithësi.


John Maynard Keynes ka deklaruar (pa bërë shaka!) se:

Figura 1. Tregu i Kriptomonedhave sipas Pjesës së Tregut




CoinDesk, 2021 dhe llogaritjet e autorëve

Figura 2. Tregu i Kriptomonedhave sipas Vëllimit



CoinDesk, 2021 dhe llogaritjet e autorëve

Figura 3. Shpërblimi për Minatorët

(Investopedia, 2021, <https://www.investopedia.com/terms/b/bitcoin-mining.asp>)

Bitcoin mbulon pothuajse gjysmën e tregut, i ndjekur nga Ethereum.

Nëse shikojmë pjesën e tregut sipas kapitalizimit, shohim se pjesa më e madhe e tregut zotërohet nga Tether, e ndjekur nga Bitcoin, e më pas nga Ethereum. Ky informacion zbulon se lojtarët kryesorë në tregun e kriptomonedhave janë pak, edhe pse ka mijëra kriptomonedha (për të mos përmendur monedhat digjitale) të tregtuara çdo ditë.

Le të përqendrohemi vetëm te kriptomonedhat. Si përshtaten kriptomonedhat me ofertën e parasë dhe politikën monetare? Si do t'i ndryshojnë ato tregjet financiare dhe ofertën e parasë? Shfaqja e kriptomonedhës në treg na kujton rrethin vicioz kundrejt cikleve virtuale. Nëse historia përsëritet, atëherë ne do të shohim se aktet qeveritare mbi kriptomonedhat dhe tregjet e kriptomonedhave do të çojnë në më shumë risi në drejtime të tjera. Për shembull, gjatë periudhës kur sistemi bankar nuk ishte i lirë në SHBA, kur çdokush që zotëronte një makinë shtypi mund të shtypte dollarët e tij, filluan të dalin aktet qeveritare. Pasi qeveria filloi rregullimin e tyre (bankave), disa nga bankat ishin në gjendje të drejtoheshin nga shtetet. Më pas, kemi sistemin bankar që ndiqte rregullore të rrepta. Një shtresë tjetër e rregulloreve kulmoi me krijimin e Sistemit të Rezervës Federale. Pastaj ndodhi Depresioni i Madh e fill pas kësaj, kemi rregullore të tjera. Gjatë viteve '80 e më tej përsëri shikojmë shoqata të kursim – kredisë që falimentojnë dhe kanë probleme. Në përgjithësi, sa herë që rregullorja synon të ketë kontroll mbi politikën monetare, atëherë banka qendrore vazhdon të kërkojë më shumë rregullore. Vendosija e një rregulloreje bëhet me një qëllimin e deklaruar për të garantuar publikun se paratë

që ata përdorin, mbajnë, marrin hua, ose investojnë, janë të sigurt. Qëllimi i pa treguar mund të jetë (mbase ka qenë) garantimi i fuqisë së monopolit ligjor që Banka Qendrore ka mbi emetimin e parave dhe të drejtën për të ushtruar politikën monetare.

Pjesëmarrësit e politikës monetare tradicionale, si: familjet, firmat, kursimtarët, huamarrësit, qeveria dhe agjencitë qeveritare do të jenë pothuajse të njëjtët. Përveç kësaj, ne do të duhet të faktorizojmë në atë që agjentët e sipërpërmendur do të përdorin kriptomonedhën si një mjet për kryerjen e pagesave, dhe disa si një mjet për të diversifikuar portofolin e tyre të investimeve. Ekziston edhe një "lojtari i ri" – minatorët (miners). Nga një jo-ekspert, ato perceptohen si nxitësit e përdorimit të kriptomonedhës. Ndërsa kjo mund të jetë e vërtetë, ato po punojnë shumë për ta bërë biznesin e tyre fitimprurës. Minatorët përdorin energjinë (këtu bëhet fjalë për shqetësime mjedisore) dhe kompjuterët për të certifikuar transaksionet, si pjesë e zinxhirit të platformës së pagesave. Shpërblimi që ata marrin vjen duke u zvogëluar. Foto më poshtë ilustron shkallën e shpërblimit, që bie në mënyrë eksponenciale. Shpërblimi që marrin minatorët për punën e tyre është ulur pasi gjetja e "nonces" (numrat e përdorur vetëm një herë) bëhet më e vështirë. Të gjithë agjentët, familjet, pensionistët, ata që presin të dalin në pension dhe firmat marrin vendime të përditshme në lidhje me kursimet, investimet dhe zgjedhjet e konsumit.

Në lidhje me çështjen e kriptomonedhave dhe bankës qendrore, i rikthehem Hayek-ut (1974). Ai nuk ishte në favor (dhe në një farë mase pajtohem me të) për centralizimin dhe monopolizimin

e parave dhe në fund në lidhje me sistemin e pagesave. Hayek do të pohonte se asnjë para e bankës qendrore nuk do të funksiononte më mirë për ekonominë, përfshirë edhe sigurimin e stabilitetit të çmimeve. Ka studime që kanë shqyrtuar periudhën e Depresionit të Madh dhe periudhën para krijimit të bankës qendrore (Banka e Rezervës Federale) dhe pas saj. Nuk ka asnjë provë përfundimtare se Rezerva Federale ka bërë ndonjë punë më të mirë se vet tregu, para se të shtetëzonte monedhën. Ne besojmë se zgjuarsia e sipërmarrësve do të zëvendësonte çdo pajisje (qoftë një mjet apo një institucion, ose qoftë një algoritëm: - blockchain, kontrata inteligjente ose shpikje të tjera) që do të vijnë në të ardhmen.

Të gjitha këto thirrje për rregullimin e qeverisë do t'i frenojnë përkohësisht shpikjet. Mendoni për shembull shpikjen e çeqeve nga bankat; një nga shpikjet më të mëdha të bankierëve. Ajo doli nga rregulloret për të kontrolluar përdorimin e parave të gatshme nga bankat e caktuara nga shteti (SHBA). Qeveria u përpoq të kontrollonte bankat dhe donte që të gjitha bankat të regjistroheshin nga OCC (Zyra e Kontrollorit të Monedhës). Për ta arritur atë, qeveria vendosi një taksë të rëndë për përdorimin e parave për bankat që nuk janë të miratuara nga OCC. Më tej, bankat shtetërore thanë se ne nuk duam të paguajmë taksa mbi paratë. Ne nuk po qarkullojmë para; ne po qarkullojmë çeqe. Normalisht pritet që këto shpikje do të ndodhnin pas përpjekjeve të qeverisë për të vendosur më shumë rregulla.

Si do të ishte politika monetare në të ardhmen? Ne mund të mendojmë se si duhet të jetë (që është thjesht gjykim - ekonomiksi normativ) dhe si do të jetë

(ekonomiksi parashikues)? Nga pikëpamja normative, besojmë (duke ndjekur linjat e të menduarit dhe historisë së Hayek-ut mbi politikën monetare) që nuk duhet të ketë shënjestrim të inflacionit, asnjë rregullim, asnjë bankë qendrore. Kjo mund të funksiononte dhe do të ishte në përputhje të përsosur me kriptomonedhën. Nga pikëpamja parashikuese, duke qenë më realistë, si dhe duke pasur parasysh faktin se ekonomitë e sotme kanë banka qendrore, sisteme bankare, sisteme pagesash dhe një risi të decentralizuar (blockchain dhe kriptomonedhat), asnjë nga ngjarjet e mësipërme gjykuese nuk do të ndodhë.

Bankat qendrore dhe qeveritë do të luftojnë për të mbajtur monopolin mbi ofertën e parave dhe, në konkurrencë me tregun e kriptomonedhave, po përpiqen të krijojnë monedhën digjitale. Guvernatori i Bankës së Anglisë bën thirrje duke treguar se sa i dobët është tregu i kriptomonedhave dhe sa e rrezikshme është që njerëzit të investojnë, ose të merren me kriptomonedha. Banka Qendrore e Kinës po krijon valutën e saj digjitale (Yuan). Rreth 80% e bankave qendrore të botës që planifikojnë të emetojnë CBCD (Monedhë Digjitale të Bankës Qendrore). Kjo do të thotë që qeveritë po konkurrojnë me tregjet e kriptomonedhave; ato do të duhet të krijojnë CBCD-të e tyre për të mbajtur monopolin mbi furnizimin e parave. Ne besojmë se politika monetare (e bankave qendrore) dhe kriptomonedha (e minatorëve), ose çdo formë tjetër e monedhave do të bashkëjetojnë. Bazuar në hulumtimin e studiuësve, duket se përdorimi i monedhës digjitale mund të disiplinojë politikën monetare të zbatuar nga bankat qendrore.

Motori i përfshirjes financiare ka nevojë për lubrifikantin e edukimit financiar, për të çuar përpara ekonominë

Një marrëdhënie e trazuar me paranë si shoqëri, ka një kosto - në një nivel individual, familjar dhe kombëtar.

GERMAN SPARKASSENSTIFTUNG
FOR INTERNATIONAL COOPERATION

Rreth 40% e shqiptarëve kanë sot një llogari bankare, e cilat mund të konsiderohet përqindje e ulët, krahasuar me mesataren e OECD-së, e veçanërisht me vendet fqinje në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, përdorimi i llogarive për pagesa elektronike është jashtëzakonisht i ulët, me rreth vetëm 4%¹. Si është e mundur kjo? Teorikisht, shqiptarët kanë akses në llogaritë bankare dhe shërbimet përkatëse, pra cila është arsyeja e mospërdorimit të tyre? Gjithashtu, edhe ata që kanë llogari bankare sa i përdorin këto të fundit, ose instrumentet financiare, në mënyrë efikase?

Përgjigjen e jep marrëdhënia që ka shoqëria me paranë, e cila fillon me edukimin financiar. Derisa të kuptohet gjerësisht se si duhet menaxhuar paraja me mençuri, në nivel individual, aspiratat për të zhvilluar ekonominë do të mbeten të vështira për t'u përmbushur. Ndërkohë, mungesa e të kuptuarit rreth parasë vjen e përkeqësohet jashtë qarqeve të privileguara socio-ekonomike, madje edhe shqiptarët e arsimuar – pjesë e klasës së



Përdorimi më i mirë i produkteve financiare do të ulë rrezikun e përgjithshëm në sektorin financiar. Rreziku i ulët do të rrisë besimin dhe besimi më i madh do të zvogëlojë problemet, e më pak probleme nënkupton më shumë transaksione.



profesionistëve – janë gjithashtu në një nivel bazik, për çështjet që lidhen me financat e tyre. Për këtë mjafton të pyeten për normën e interesit që paguajnë për kartën e tyre të kreditit të papaguar.

Pjesërisht arsyeja për këtë gjendje është kulturore – rregulli i mos pyetjes për nivelin e pagës së dikujt përkthehet në një kulturë të heshtjes rreth parave, heshtjes rreth vështirësive lidhur me paratë dhe shqetësimet e lidhura me përdorimet jo-optimale të të ardhurave dhe huave.

Të mbetur me këshillatë vjetruara, të krijuara nga përvojat personale, shqiptarët përvetësojnë sjellje ndaj administrimit të parave, kryesisht nga prindërit e tyre, të cilët shpesh e

neglizhojnë dhënien e udhëzimeve për gratë. Vetëm 20% e grave në Shqipëri janë të vet-punësuar dhe rreth 80% e këtyre ndërmarrjeve në pronësi të grave mund të konsiderohen mikro-biznese, ose biznese të vogla me qarkullim relativisht të vogël, ndonëse shumica e ndërmarrjeve të mesme e të mëdha, 80,4% e tyre, janë në pronësi të burrave². Nëse bizneset e vogla janë motori i rritjes, që e çon një vend drejt begatisë ekonomike, atëherë motori po gulçon ndjeshëm. I vetmi lubrifikues është të kuptuarit sa më të gjerë të koncepteve ekonomike.

E gjithë kjo ka rezultuar në krijimin e një ekosistemi të shërbimeve financiare, që është i orientuar drejt uljes së rrezikut, përmes proceseve të vështira, procedurave të shumta për t'u kapërcyer dhe një përvojë, që përfundon me përjashtimin, pa dashje, të njerëzve, në vend që të promovojë sjellje financiare të përgjegjshme dhe të hapë rrugë për përfshirje financiare, duke filluar nga një llogari e thjeshtë bankare. E vërteta është se, një marrëdhënie e trazuar me paranë si shoqëri, ka një kosto - në një nivel individual, familjar dhe kombëtar.

Duke u thelluar pak më shumë në këtë temë, zbulohet se ka disa fusha të mëdha në të cilat vërehet ndikimi i programeve të edukimit financiar³, si:

¹ Banka Botërore 2017: Zhvillimet në Tregun e Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri.

² INSTAT Shqipëri, 2019.

³ Bruegel Policy Contribution, May 2018

- Mundësi më e madhe për planifikim pensioni dhe më shumë akumulim fondi pensioni, si dhe dhe një diversifikim më të mirë të aktiveve. Përgjithësisht, individët me nivel të ulët të edukimit financiar kanë më pak të ngjarë të planifikojnë fonde për pension, duke krijuar kështu shpesh probleme financiare, kur arrijnë moshën e pensionit.
- Ndërgjegjësim më i lartë, në drejtim të vendimeve për huamarrje. Studimet tregojnë se individët me edukim të ulët financiar janë të prirur të marrin hua me norma më të larta.
- Shpërndarje më e mirë e burimeve gjatë gjithë jetës. Në kohë krize, familjet me nivele të ulëta të edukimit financiar kanë më shumë të ngjarë të shesin pasuritë e tyre (d.m.th. pasuri të paluajtshme, aksione, makina) me humbje, kur krijohen nevoja afatshkurtra për likuiditet. Kjo sjellje ndikon ndjeshëm në mundësitë afatgjata për akumulim të pasurive/kursimeve.
- Planifikim dhe kursime më të mëdha nga gratë dhe individët me të ardhura të ulëta. Programet e edukimit financiar që synojnë veçanërisht gratë dhe individët me të ardhura të ulëta rezultojnë në marrjen e masave të menjëhershme të tyre për rritjen e kursimeve dhe rritjen e moshës së pensionit. Për më tepër, këto veprimtari janë relativisht më pak të kushtueshme dhe efikase.
- Rritja e kursimeve dhe sjelljes së planifikimit mesfëmijëve dhe të rinjve. Sofistikimi financiar, i inkurajuar nga edukimi ekonomik në moshë të re, ka një ndikim të ndjeshëm pozitiv në edukimin financiar, d.m.th. arsimit ekonomik është një parashikues i fortë i edukimit më të madh financiar. Është fakt se, nxënësit dhe studentët që janë ekspozuar ndaj edukimit ekonomik dhe financiar, shfaqin një përmirësim të dukshëm, për sa i përket aspekteve të buxhetimit, negocimit të çmimeve dhe metodave

të pagesës. Detyrat e shtëpisë, që përfshijnë llogaritjen e buxheteve familjare dhe krahasimin e normave të interesit kishin një efekt pozitiv edhe në sjelljen financiare të prindërve.

Duke pasur parasysh këto gjetje, çfarë mund të bëhet në Shqipëri?

Nisur nga përvoja e German Sparkassenstiftung (DISK) në projektet e edukimit financiar në të gjithë botën, disa orientime të përgjithshme do të ishin⁴:

- Fillimi i edukimit financiar herët në shkollë, pasi kjo çon në përmirësim të ndjeshëm të sjelljes buxhetuese të individëve. Kështu, ai duhet të përfshihet në programet shkollore, por me një fokus të madh në cilësinë e programeve (përfshirë dhe trajnimin e mësuesve).
- Programet “një masë një kut” nuk funksionojnë; ato duhet të përshtaten sipas nevojave të komuniteteve të veçanta (të rinj, gra, grupe me të ardhura të ulëta, familje).
- Edukimi financiar është një proces i të mësuarit gjatë gjithë jetës. Duhet siguruar edukim financiar para se të ndodhin “ngjarje” të ndryshme financiare (d.m.th. nënshkrimi i një huaje hipotekare, investimi në lloje të ndryshme fondesh pensioni). Këto lloj shërbimesh këshillimi janë provuar se kanë sukses.
- Përfshirja e sektorit privat është thelbësore, pasi institucionet financiare janë në pararojë të edukimit financiar. Sidoqoftë, kjo është sfiduese, pasi përvojat negative me institucionet financiare do ta bëjnë më të vështirë detyrën e “edukatorëve”.
- “Më shumë” nuk do të thotë domosdoshmërisht “më mirë”, pasi mbingarkesa e informacionit dhe e edukimit mund të dekurajojë individët nga marrja e vendimeve financiare. Prandaj është e rëndësishme të realizohet përshtatje me perspektivën e konsumatorit,

lidhur me atë çka ai ka nevojë dhe si ai mund ta përpunojë informacionin.

- Vlerësimi i njohurive dhe sjelljes financiare. Meqenëse edukimi financiar i ka të dy aspektet, si atë edukues dhe atë të sjelljes, është thelbësore të kuptohet efekti i programeve edukuese në sjelljen financiare të individëve. Marrja pjesë në sondazhe të standardizuara, në shkallë të gjerë, siç janë sondazhet e OECD-së, do të japë perceptimet e duhura dhe të rëndësishme.

Për sa i përket njohurive dhe përfshirjes financiare, Shqipëria sigurisht që ka ende një rrugë të gjatë për të bërë. Sidoqoftë, në vitet e fundit është shënuar progres: Veprimtaritë e Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe ANFE-s (Rrjeti Shqiptar për Edukimin Financiar), kanë qenë një hap i parë i madh në drejtimin e duhur, sikundër dhe ato të ndërmarra nga bankat dhe institucionet e ndryshme, për të rritur njohuritë e shqiptarëve rrethe çështjeve financiare. Për më tepër, ligji i ri për sistemet e pagesave krijon mundësi për bankat, fintech-sat dhe start-up-et për të krijuar produkte novatore, duke përdorur infrastrukturën digjitale. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare po udhëheqin tashmë procesin e krijimit të një Strategjie Kombëtare për Përfshirjen dhe Edukimin Financiar, e cila duhet të përmbajë disa prej elementeve të përshkruara më sipër.

Cili do të ishte rezultati i mundshëm? Përdorimi më i mirë i produkteve financiare do të ulë rrezikun e përgjithshëm në sektorin financiar. Rreziku i ulët do të rrisë besimin dhe besimi më i madh do të zvogëlojë problemet, e më pak probleme nënkupton më shumë transaksione. Në mënyrë figurative, nëse volanti fillon të rrotullohet, e gjithë ekonomia ecën përpara, duke marrë me vete çdo individ në vend.



⁴ Krahasoni raportet e projekteve të ndryshme në: www.sparkassenstiftung.de.

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE E KORPORATËS



- Në datë 1 qershor, banka iu bashkua Kryqit të Kuq – Dega Tiranë dhe dhuroi pako ushqimore për 70 familje në vështirësi dhe organizoi një veprimtari festive për fëmijët e tyre, ku u shpërndanë dhe dhurata.
- Mbështeti publikimin e libërthit dhe CD-së: “Ta dish”, një përmbledhje këngësh tradicionale shqiptare nga baritoni me famë ndërkombëtare Gëzim Myshketa.
- Në ankandin e dhurimit #RrathëDhurues2021, organizuar nga Partners Albania for Change and Development ofroi mbështetje për kauzën “Këndi i Studimit”, prezantuar nga organizata “Tek Ura” dhe do të mundësojë kënde studimi për fëmijët e familjeve në vështirësi në zonën e Tufinës.

- Në ankandin e dhurimit live: “Rrathë Dhurues 2021”, ofroi mbështetje për dy prej nismave të prezantuara: Nisma e parë do të synojë përmirësimin e jetës së 126 fëmijëve të komunitetit “Lanabregas” në Tiranë, nëpërmjet ofrimit të një këndi lojërash. Nisma e dytë do të mundësojë për 15 familje në vështirësi ekonomike me nga 3-5 fëmijë në zonën e Tufinës në Tiranë, nga një kënd studimi në banesat e tyre dhe mjetet e duhura shkollore.
- Mbështeti Shkodra Jazz and Swing, në datat 29-30 maj.
- Mbështeti koncertin televiziv: “Rock the Dictator”, nga Renis Gjoka.



- Mbështeti Drejtorinë Arsimore Vlorë në përmirësimin e kushteve të punës në këtë institucion.
- Mori pjesë në Panairin Virtual të Punës dhe Aftësive 2021. BKT, si mbështetëse e rregullt e këtyre organizimeve, ofron mundësi punësimi si dhe praktika për ata që janë të interesuar.



- Bëhet pjesë e fushatës së ndërmarrë nga Fondacioni Global Shqiptar gjatë muajit qershor: “Ndërtimi i së Ardhmes”. Kjo nismë do të ofrojë mbështetje për 6 OJF, me fokus programet për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri. Banka ofroi mbështetje për Fondacionin “Mirësia”, në pajisjen me syze optike për disa fëmijë jetimë në qytetet: Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Sarandë.



- Në vijim të nismës “Food Bank”, u shpërndanë ndihma ushqimore për 90 familje në nevojë në qytetet: Berat, Vorë dhe Lezhë.
- Mbështeti Kryqin e Kuq

Shqiptar me dhurimin vullnetar të gjakut, si dhe për projektet sociale në ndihmë të fëmijëve jetimë, e të moshuarve në nevojë.


- Me rastin e 1 Qershorit dhuroi librin: "Përrallat e Pitolushes" në kopshte, shkolla në Burrel, Pogradec dhe Fushë-Krujë.
- Dhuroi libra për bibliotekën "Vexhi Buharaja" në Berat.
- Dhuroi pajisje në përmirësimin e kushteve të punës për disa institucione, si: Kryqi e Kuq, Dega Berat; Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastër; Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier; Spitalin "Shefqet Ndroqi".
- Në mbështetje të Bashkisë Tiranë mundësoi bursa për 370 nxënës, të moshës 12-18 vjeç, që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta, si një mundësi për këta fëmijë të talentuar, që kanë pasion artin dhe teknologjinë, për të ndjekur programet e shumëllojshme që ofrohen në TUMO, qendrën më moderne në Tiranë.
- Vazhdoi projektin për shtimin e stacioneve të biçikletave pranë çdo dege, jo vetëm në Tiranë, por dhe në qytetet e tjera ku banka është e pranishme.
- Mbështeti "Konkursin e bizneseve të Gjelbërta", në bashkëpunim me Partners Albania for Change and Development.
- Mbështeti Konferencën Ndërkombëtare "Shaping the future: Digital Economy and recent technology trends", organizuar nga Canadian Institute of Technology.
- Mori pjesë në eventin: "Rrathë dhurues 2021",

duke mbështetur nismën e prezantuar: Ndërtimi i një këndi lojërash në komunitetin "Lanabregas", që do t'i shërbejë më shumë se 100 fëmijëve të kësaj zone.

- Mbështeti veprimtarinë e paragliding: Albania Open "Edicioni 22" të organizuar nga Aeronautika.
- Mus pracitus, qua eterce



- Në muajin prill, Fibank nxorri një paketë shërbimesh bankare kushtuar pensionistëve që duan të marrin pensionin përmes bankës. Fibank jep një bonus për të gjithë pensionistët që do të vijnë e që do të përfitojnë gjithashtu një llogari bankare të lidhur me një kartë debiti falas, norma të larta interesi për kursimet e tyre, pagesa pa komision për shërbimet publike, dhe mirëmbajtjen falas të llogarisë.
- Kombet e Bashkuara caktuan 21 Prillin si Ditën Botërore të Krijimtarisë dhe Inovacionit, për të rritur ndërgjegjësimin rreth rolit të krijimtarisë dhe inovacionit në të gjitha aspektet e zhvillimit njerëzor.
- Fibank Albania mundësoi një aplikacion të thjeshtë dhe të shpejtë në celular, përmirësoi platformën e saj E-banking, prezantoi ATM-të e reja të teknologjisë së lartë, që ofrojnë mundësi tërheqje dhe depozitë 24/7, lançoi funksionin e saj 3D të sigurisë për të gjitha kartat, si dhe përditësoi sistemin, për të ofruar zgjidhjet më të mira



digjitale për të gjithë.



- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Vajzave që punojnë në TIK, banka punon me partnerët për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me ndarjen digjitale gjinore, për të mbështetur edukimin teknologjik dhe trajnimin e aftësive. Fibank është krenare që investon në një ekip të tillë si: Ejona, Anila, Vaje & Elona.
- Fibank sponsorizoi festimin e 1 Qershorit, duke shpërndarë dhurata për fëmijët dhe familjet e tyre nëpërmjet Fondacionit "Down Syndrome Albania", të cilët festuan gjithashtu vitin e tyre të 7-të të shërbimit të përkushtuar ndaj komunitetit.



- Në 2 Prill, Ditën Botërore të Ndërgjegjësimit mbi Autizmin, selia qendrore e ISBA u ndriçua me blu për të rritur ndërgjegjësimin mbi Autizmin. Banka ftoi të gjithë kolegët të bënin një foto (ose selfie) të veshur me bluza me ngjyrë blu, ndërsa punonin nga shtëpia ose pas orarit të punës, në shenjë solidariteti dhe të postonin fotot në profilet e tyre në mediat sociale. Një kartolinë e brendshme u përgatit dhe u shpërnda gjithashtu në rrjetet sociale.
- Në 7 Prill, Ditën Botërore të Shëndetit dhe në 22 Prill, Ditën Ndërkombëtare të Tokës ISBA rriti ndërgjegjësimin e publikut përmes kartolinave.
- Në seminarin online të

organizuar në 15 prill nga Kombet e Bashkuara në Shqipëri dhe Kompakti Global mbi "Zbatimin e Objektivave Globale nga Bizneset Lokale" ishte e pranishme znj. Arla Kraja, Përfaqësuese për PSK dhe Komunikimin e Brendshëm të Intesa Sanpaolo Bank Albania, e cila prezantoi se si i zbaton banka politikatat e saj të brendshme në mbështetje të OZHQ-ve.

- 22 prilli shënon Ditën Ndërkombëtare të Vajzave që punojnë në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit! Përmes një video të shkurtër banka prezantoi gratë që punojnë në këtë Divizion. Në ISBA reeth 45% e Divizionit të TIK-ut përbëhet nga gra!
- Në 28 Prill, Ditën Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ISBA përgatiti një video të shkurtër, duke theksuar rëndësinë e shëndetit dhe sigurisë në punë.
- 15 Maji, Dita ndërkombëtare e familjeve dhe 16 Maji, Dita Ndërkombëtare e Jetesës në Paqe! ISBA i promovoi këto ditë në mjediset e saj dhe në rrjetet sociale.
- Më 21 maj ISBA organizoi nismën e parë të dhurimit vullnetar të gjakut për vitin 2021.
- 31 maji shënon Ditën Botërore pa Duhan! Në këtë ditë ISBA shpërndau një video për punonjësit për të rritur vetëdijen lidhur me dëmet që shkakton duhani.
- Intesa Sanpaolo Bank Albania iu bashkua veprimtarive të ISBD, në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit (5 qershor 2021). Nga 1 deri më 7 qershor,



kolegët morën informacione interesante dhe kartolina lidhur me Ditën Botërore të Mjedisit. Ata, gjithashtu, u ftuan të bashkohen me fushatën më 5 qershor, në faqet zyrtare të bankës në rrjetet sociale (Pëlqe dhe Shpërnda)!

- Filloi nismën e veçantë unike për Edukimin Financiar, në stacionin televiziv A2CNN dhe në të gjitha rrjetet sociale të bankës: "Edukimi Financiar për të Gjithë".
- Intesa Sanpaolo Bank - Albania dhe Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) nënshkruan në 22 qershor 2021 një marrëveshje bashkëpunimi, e cila u mundëson studentëve të kryejnë praktikën në Intesa Sanpaolo Bank - Albania, si dhe sigurimin e leksioneve të hapura të menaxherëve të bankës.
- ISBA u bashkua me nismën e ISBD, për organizimin e seancave online të fitness-it, për punonjësit.



- Banka mundësoi vizitën e nxënësve të klasës së gjashtë të shkollës publike "Edit Durham" në muzeun Arkeologjik të Korçës.
- Në vijim të veprimtarive të zhvilluara në Muzeun Arkeologjik të Korçës, u organizuan veprimtari dhe me pjesëmarrjen e stafit të bankës, që kaluan një të shtunë së bashku dhe




vizituan këtë muze. Studimi i historisë vlerësohet nga Grupi Ndërkombëtar i Bankave ProCredit (me qendër në Frankfurt, Gjermani). Pjesë e rëndësishme e trajnimeve që stafi i bankës ProCredit bën janë dhe trajtimi i temave mbi historinë dhe kulturën.

- Përfaqësues të bankës ProCredit dhanë një orë leksion të hapur për nxënësit e Shkollës Jopublike "Kristaq Rama" në Tiranë. Gjithashtu, u dhuruan dhe libra rreth qytetërimit të hershëm Evropian.



Pjesë e Grupit RBI

- Për të 9-in vit radhazi ishte sponsor kryesor i konkursit mbarëkombëtar Albanian ICT Awards.
- Në kuadër të ditës Botërore të Mjedisit, stafi i bankës, në bashkëpunim me Korpusin Shqiptar të Vullnetarëve, pastruan plazhin dhe parkun e pishave të Zvërnecit. Gjatë këtij viti janë organizuar aksione dhe në plazhet publike në zonën Fshati Rinia, Durrës dhe plazhin e Velipojës. Falë këtyre aksioneve vullnetare është bërë e mundur pastrimi i më se 4 km vijë bregdetare, prej nga u zhvendosën mbi 150 thasë me mbetje.
- Mbështeti realizimin e 5 trajnimeve nga Qendra WIT Albania. Gjatë projektit: "Edukimi Financiar në Epokën Digjitale" u trajnuan rreth 200 nxënës të shkollave "Eqrem Çabej", "Bajram Curri" dhe



“Gjon Buzuku” në kryeqytet.





- Më datë 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve, Muzeu Historik Kombëtar lançoi me mbështetjen e Raiffeisen aplikacionin audio-guidë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast e kësaj morën pjesë z. Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm, Znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës dhe Z. Dorian Koci, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar.
- Raiffeisen Bank ishte e pranishme në Panairin e 8-të të karrierës të Universitetit “EPOKA”.
- Mbështeti eventin: “Dritarja e shpresës” dhe festivalin e Shkollave të Mesme të Tiranës TK-RIN-ART, në datat 24-26 maj. Në kuadër të Programit “Edukimi mbi dhe përmes kulturës” Teatri Kombëtar ngjiti në skenë 18 të rinj të talentuar dhe në këtë edicion u shpallën katër fitues.
- Në muajin Maj, i cili njihet ndërkombëtarisht si muaji i promovimit të profesionit të Auditimit të Brendshëm, Divizioni i Auditit të Brendshëm (AB) pranë Raiffeisen Bank, zhvilloi një sërë veprimtarish, si:
 - Marrja pjesë në Kampionatin Evropian të Audituesve të Brendshëm.
 - Realizimi i dy spoteve/ videove, ku prindër të stafit të AB u shpjegojnë fëmijëve të tyre me fjalë të thjeshta, rolin dhe profesionin e auditorëve të brendshëm brenda një organizate.
 - Shkrimi i një artikulli: “Mitet e rolit dhe funksionit të AB”.
 - Marrja pjesë në 2 Podcast-e me tema të përzgjedhura,

brenda komunitetit lokal të auditorëve të brendshëm, si për GDPR dhe 3 Linjat e Mbrojtjes.

- Realizimi i fotove me grupe, si edhe i një feste me stafin.



- Në mbështetje të artit, nëpërmjet programit “Dhuro kulturë” nga fondacioni “Arte”, dhuroi një piano për shkollën 9 vjeçare “Jeronim de Rada”.
- Banka iu përgjigj kërkesës për ndihmë të Shoqatës “Shqipëria” në Vlorë, duke shpërndarë pako ushqimore për këto familje.
- Me rastin e çeljes së sezonit turistik dhe promovimin e tij në qytetin e Pogradecit, mori pjesë në panairin njëditor, të organizuar në këtë qytet.
- Prodhuesit shqiptarë dhe artizanët janë një faktor kryesor i rritjes ekonomike të vendit dhe i krijimit të vendeve të punës. Banka mbështeti Ditën Kombëtare të Vajit të Ullirit, në 19 qershor, në qytetin e Vlorës.
- Mbështet Albania Social Club për krijimin e një videoje promovionale për Shqipërinë.
- Për të mbështetur të gjithë lexuesit, OTP Bank vendosi të japë kontributin e saj për promovimin online të librit.
- Sponsor i klubit të basketbollit “Partizani” (meshkuj).



Ofertat

Speciale



PAGA IME

Mund ta tërhiqni atë me kartën tonë të debitit në më shumë se **700 ATM** që mbajnë logon MasterCard në të gjithë vendin **PA KOMISION**

Përse UBA Debit Card?

- ✓ Praktike, e shpejtë, e lehtë në përdorim;
- ✓ Mundësi aksesimi në llogarinë tuaj 24 orë në ditë 7 ditë në javë;
- ✓ Tërheqje në çdo ATM në mbarë botën, mjafton që ATM te ketë logon e MasterCard;
- ✓ Mundësi blerje në të gjitha pikat e shitjes (POS) në Shqipëri dhe jashtë saj me logot e MasterCard;
- ✓ FALAS për blerjet në POS, brenda dhe jashtë vendit
- ✓ Pa kontakt, pagesa pa vendosur Pin-in dhe pa firmosur fatura.

TIRANA BANK

- Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar kontribuoi në dhurimin e 104 kutive me artikuj të ndryshëm ushqimorë. Nën moton "Gjeste të vogla me dashuri të madhe" përfaqësues nga stafi i bankës ishin të pranishëm çdo ditë të premte në muajin Maj pranë mensës së Kryqit të Kuq.
- Tirana Bank, me nismë të Z. Samir Mane, President i Grupit Balfin, vendosën të dhuronin 1.2 milionë euro në ndihmë familjeve të prekura më rëndë nga tërmeti i vitit 2019. Familja Rama, nga Spiteni i Lezhës u rikthye të banojë në një strehë të sigurt, ashtu si 10 familje të tjera që kanë marrë apartamente nga Grupi Balfin deri më tani. Z. Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, dhe Z. Stefan Çipa, Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave, ishin të pranishëm në qytetin e Lezhës për të bërë dorëzimin apartamentit.
- Nën moton: "Këtu për jetën" vijoi traditën e saj për dhurimin e gjakut edhe këtë vit.

së Kryqit të Kuq Shqiptar për të përmbushur nevojat për gjak për fëmijët talasemikë.

- Në vijim të procesit të vaksinimit të popullsisë ndaj Covid-19, Union Bank dhuroi për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës një frigorifer, që do të shërbejë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vaksinave.



- Në vijim të mbështetjes së familjeve në nevojë, e kthyer në traditë për muajin e Ramazanit, banka shpërndau 350 kuti me ushqime familjeve myslimane në Shqipëri, kryesisht në Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Elbasan, Librazhd, Kukës dhe Dibër.
- U finalizua donacioni në disa pajisje për Spitalin Rajonal të Shkodrës.
- Në bashkëpunim me Universitetin "AL Bukhary" në Malajzi u ofruan bursa studimi për fëmijët e familjeve në nevojë.
- Lidhi një marrëveshje për mbështetje financiare për fëmijën e Heroit Arian Sala, që u sakrifikuara për të shpëtuar jetën e kolegeve të tij, pas një shpërthimi zjarri të ndodhur në magazinën e një qendre tregtare në Tiranë.



UNIONBANK

- Në datë 2 qershor, nën monton: "Dhuro gjak, shpëto jetë", stafi i Union Bank ju përgjigj thirrjes

Tirana Bank njofton emetimin e obligacioneve korporative në vlerën 5 milionë Euro

Tirana Bank njofton emetimin e obligacioneve korporative afatgjata në vlerën 5 milionë Euro. Këto obligacione kanë një afat 7 vjeçar me një normë fikse interesi prej 3,30% në vit, të pagueshme çdo gjashtë muaj. Fondet e realizuara nga emetimi i obligacioneve do të rrisin kapitalin shtesë të Bankës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe miratimeve nga autoritetet rregullatore.

Ky obligacion përfaqëson një nga emetimet më të mëdha, në kuadër të një transaksioni të vetëm, të këtij lloji instrumenti në tregun lokal, i nënshkruar plotësisht nga klientë individë dhe klientë premium. Kërkesa ishte më e madhe krahasuar me ofertën fillestare të këtij obligacioni.

AAB AKTIVITETE & TRAJNIME

Mbledhja e Asamblesë së AAB-së dhe Zgjedhjet

Në datën 15 prill 2021 u zhvillua mbledhja e Asamblesë së AAB-së. Sipas agjendës dhe në

përputhje me statutin e AAB-së, u zgjodh Bordi Mbikëqyrës i Shoqatës, me pesë anëtarë. Anëtarët e zgjedhur janë:

Z. Bledar Shella

Drejtor i Përgjithshëm i OTP Bank Albania;

Z. Seyhan Pencabligil

Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare (BKT);

Z. Maltin Korkuti

Drejtor i Përgjithshëm i Credins Bank;

Z. Dritan Mustafa

Drejtor i Përgjithshëm i Tirana Bank;

Z. Bozhidar Todorov

Drejtor i Përgjithshëm i FIBank Albania.

Kryetar i Bordit Mbikëqyrës u zgjodh z. Bledar Shella dhe z. Seyhan Pencabligil u zgjodh Zëvendës Kryetar.

Trajnim mbi Falimentimin

Më 14-15 prill, AAB bashkëpunoi me IFC dhe mundësoi pjesëmarrjen e juristëve të bankave në trajnimin online: "Zbatimi i ndërmjetësimit në zgjidhjen e çështjeve të falimentimit në Shqipëri". Pjesëmarrësit u vlerësuan me certifikata.

Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mori pjesë në takimin e 51-të të Anëtarëve të Asociuar të EBF-së

AAB mori pjesë në takimin e 51-të të Anëtarëve të Asociuar të Federatës Evropiane të Bankave, i cili u mbajt më 17 maj 2021, përmes një lidhje video, me selinë

në Bruksel. Hapja dhe propozimi për efektivitetin e këtyre takimeve u bë nga Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i AAB-së.

Takimi i Bordit Mbikëqyrës të AAB-së me Z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë

Më datë 29 qershor 2021, anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të AAB-së, të kryesuar nga Kryetari i saj, z. Bledar Shella dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, z. Spiro Brumbulli, zhvilluan një takim-diskutimi me z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë. Të pranishëm ishin gjithashtu Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatorja e Dytë, zj. Natasha Ahmetaj dhe drejtues të tjerë të Bankës së Shqipërisë. Ky takim u zhvillua në kuadër të dialogut të vazhdueshëm mes Bankës së Shqipërisë dhe industrisë bankare, mbi çështjet që lidhen me veprimtarinë dhe rolin e tyre në ekonomi.



Mbi Standardet e Përbashkëta të Raportimit (CRS)

Në 16 prill u organizua një takim me përfaqësuesit e bankave dhe DPT-së, i përqendruar në raportimin vjetor/periodik sipas Standardeve të Përbashkëta të Raportimit (CRS). Këtu morën pjesë 31 përfaqësues teknikë. Pas takimit, iu dërguan

DPT-së një përmbledhje e të gjithë çështjeve të diskutuara.

AAB organizoi ceremoninë përcjellëse për Z. Silvio Pedrazzi

Më 16 qershor 2021, AAB organizoi ceremoninë përcjellëse për z. Silvio Pedrazzi, me rastin e përfundimit të detyrës si Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Intesa Sanpaolo Bank - Albania.



Regjistri qendror për llogaritë bankare

Zyra Ekzekutive e AAB-së u angazhua intensivisht në diskutimet me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, DPT, dhe prezantoi problemet kryesore të bankave, lidhur me raportimin e të dhënave në Regjistrin Qendror të llogarive bankare.

Më 10 maj, AAB i dërgoi një letër Ministrin të Drejtësisë dhe DPT-së, përmes së cilës u prezantuan shqetësimet e bankave.

Në datat 17 dhe 22 qershor u organizuan dy takime online, ku morën pjesë bankat, përfaqësuesit e DPT-së dhe AKSHI-t. Në takimin e 22 qershorit mori pjesë edhe zj. Delina Ibrahimaj, Drejtore e Përgjithshme e DPT-së.

Mbi procesin e Fiskalizimit

Zyra Ekzekutive e AAB-së vijoi komunikimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi procesin e fiskalizimit, duke paraqitur shqetësimet e bankave dhe paqartësitë rreth këtij projekti.

Më 28 maj u zhvillua një takim online me përfaqësuesit e DPT-

së, i cili u përqendrua në çështjet kryesore teknike të bankave, lidhur me zbatimin e projektit të fiskalizimit. Në takim, morën pjesë mbi 70 përfaqësues të bankave.

Më 3 qershor, Zyra Ekzekutive e AAB-së, përmes një letre dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe në vëmendje edhe të DPT-së, kërkoi shtyrjen e afatit të caktuar, pasi procesi i fiskalizimit midis tatimpaguesve (B2B) fillon në 1 korrik 2021. Gjithashtu, AAB kërkoi që të merret në konsideratë një periudhë prove për kryerjen e procedurave pa gjobitjet e parashikuara nga baza ligjore.

Në datat 3 dhe 10 maj u organizuan dy takime teknike online me bankat, DPT-në dhe përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë

së Informacionit (AKSHI), për të diskutuar rreth çështjeve kryesore teknike të bankave, lidhur me zbatimin e procedurave të fiskalizimit. Në këtë takim morën pjesë përkatësisht 91 dhe 82 përfaqësues të bankave dhe DPT-së.

Komitetet Teknike të AAB-së

Sipas përcaktimeve të statutit të ri të AAB-së, u konstituua përbërja e 7 komiteteve të reja teknike të AAB-së. Më shumë informacion rreth përbërjes së tyre mund të gjendet në faqen e internetit të AAB-së: www.aab.al.

Muaji ndërkombëtar i ndërgjegjësimit për auditimin e brendshëm

Gjatë takimit të majit, anëtarët

e Komitetit të Auditit të AAB-së festuan Muajin Ndërkombëtar të Ndërgjegjësimit për Auditimin e Brendshëm.



Fillon vaksinimi i punonjësve të sektorit bankar

Nën koordinimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe në bashkëpunim me departamentet e Burimeve Njerëzore të bankave anëtare, filloi procesi i vaksinimit kundër COVID-19, për punonjësit e sektorit bankar

EDUKIMI FINANCIAR

Finalja e Konkursit Evropian të Parasë

Në 21 prill, nxënësit 13-15 vjeç të shkollat e mesme në të gjithë Evropën garuan me njohuritë e tyre financiare në Finalen e Konkursit Evropian të Parasë, një konkurs online i organizuar nga Federata Evropiane e Bankave, që përmbylli sezonin e konkursit të këtij viti. Shqipëria u përfaqësua nga finalistët e konkursit kombëtar për këtë qëllim.



Rrjeti Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE) zhvillon takimin e 11-të

ANFE zhvilloi takimin e tij të 11-të në datë 21.05.2021, i cili

u organizua dhe kryesua nga Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës. Pjesëmarrësit në këtë takim virtual diskutuan një sërë temash me interes për tregun financiar, të cilat harmonizohen me kontributin e ANFE-së, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit rreth edukimit financiar dhe përmirësimit të nivelit të tij në të gjitha grupet e popullsisë.

Leksioni i hapur

Më 4 qershor, AAB, e përfaqësuar nga zj. Admira Mlika, Drejtuese në Departamentin e Riskut të Kredisë në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), organizoi një leksion të hapur me temë: "Menaxhimi i Riskut të Kredisë në situatën e pandemisë Covid-19", me pjesëmarrjen e studentëve nga Fakulteti i Biznesit, programi Master Shkencor, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.

TRAJNIMET E ORGANIZUARA GJATË PRILL – QERSHOR 2021

- ✓ Trajnim mbi leadershipin e zhdërvjellët pragmatik dhe certifikimin CPAL, në bashkëpunim me Agisolve, 6-8 prill.
- ✓ Ndërtimi dhe promovimi i kulturës së organizatës, në kuadër të punës në distancë dhe në ndryshim e sipër, gjatë kohës së pandemisë, në bashkëpunim me Lincoln Center, 27 dhe 28 prill 2021.
- ✓ Siguria kibernetike në epokën digjitale, në bashkëpunim me AIIA, 5 & 6 maj.
- ✓ Kurs Fillestar për Analizë Biznesi, në bashkëpunim me AIIEx, në 2, 3 dhe 4 qershor.
- ✓ AAB, në bashkëpunim me ATTF/ House of Trainings Luxembourg, ofroi trajnimet e mëposhtme:
- ✓ Menaxhimi i Rrezikut në Banking, 13 - 16 prill & 22 - 23 prill 2021.
- ✓ Hyrje në Financat Digjitale, 7 maj.
- ✓ Metodatat e orientuar nga biznesi për shfrytëzimin e të dhënave gjatë procesit të "Data Mining", 19 & 21 maj.
- ✓ Trajnimi i trajnerëve, 1, 2, 4 8 dhe 9 qershor.

